

MËSOJ LIBRIN TIM



BOTIMET E BASHKËSISË FETARE TË DIJANETIT

M È S O J
LIBRIN TIM







Botimet e Bashkësisë Fetare të Dijanetit: 641
Librat e Fëmijëve: 163

MËSOJ LIBRIN TIM

Autor

Osman Özbağçe

Fotografues

Dağıstan Çetinkaya

Koordinator

Dr. Ömer Menekşe

Redaktor

Ahmet Sadriu

Përktheu

Zymer Ramadani

Redaktor i përkthimit

Dr. Abdullah Hamiti

Recensent

Sabri Bajgora

Lektor

Isa Bjaçinca

Korrektor

Ramadan Shkodra

Rradhitja Grafike

Nurgül Moldaliev

Shkrimi mbrapa kopertinës

Nga Libri *Syryn* i Sezai Karakocit

Vendimi i marrur nga komisioni i lartë për
qështje fetare

01.09.2005 /142

2008-06-Y-0003-641

ISBN 975-19-3791-4

Botimi

Yeniğün Matbaacılık

0 (312) 384 61 83

© Bashkësia Fetare e Dijanetit

Botimet e Zyrës Fetare

Adresa Kontaktuese

Eskişehir yolu 9. km. Çankaya / Ankara

Tel. : 0 (312) 295 73 06

Faks : 0 (312) 284 72 88

www.diyenet.gov.tr

diniyayinlar@diyanet.gov.tr

PREZANTIM

Përrshëndetje fëmijë!

Është detyra jonë parësore e të gjithëve, që ta lexojmë dhe kuptojmë Kuranin që Allahu xh.sh. ia dërgoi Pejgamberit për të na udhëzuar në rrugë të drejtë dhe për të na bërë të lumtur. Ne duhet t'i vëmë veshin thirrjes së tij të shenjtë dhe duhet ta kuptojmë atë.

Pa e njohur mirë Kuranin, e kemi vështirë ta kuptojmë atë. Librin që keni në duart tuaja, u munduam t'ju shpjegojmë juve, se çfarë libri është Kurani, ç'përmban ai, si i ndryshoi njerëzit dhe bashkësitë njerëzore, dritën që përmban për jetën e kësaj bote dhe të botës së përtejme, dhe shembujt e sakrificave të pejgamberëve.

Kurani famëlartë, së pari na tregon për Krijuesin tonë. Na tregon se si Ai krijoi gjithësinë, të gjitha gjallesat dhe njeriun. Na mëson se si t'i bëjmë dua/lutje Zotit tonë. Sikur na tregon për të mirat dhe gjërat e dobishme, ai na këshillon që të qëndrojmë larg veprave të këqija dhe të shëmtuara. Ai na tregon për vetveten tonë. Na tregon detyrat tona ndaj familjes, ndaj popullit dhe ndaj gjithë njerëzve e ndaj krijesave të tjera.

Nëse i besojmë librit tonë dhe praktikojmë urdhrat e tij, ne do të bëhemi shumë të lumtur.

Allahu na do ne shumë. Meqë na do ne, për të na udhëzuar në rrugë të drejtë, Ai na dërgoi Pejgamberin Muhamed. Ai, atij ia mësoi librin tonë të shenjtë. Kurse Pejgamberi a.s., së bashku me ne, praktikoi shembujt e tij. Neve dhe gjithë njerëzimit na tregoi rrugën e shpëtimit.

Ne e duam shumë Allahun. Ai na mësoi dashurinë. Gjithësinë dhe ç'ka në të, Ai i krijoi për ne. Ai na dha jetë, shëndet dhe lumturi.

Ne duam çdo gjë që ka krijuar Allahu xh.sh.: njerëzit, shtazët dhe natyrën. E dimë se jemi përgjegjës ndaj tyre. Përpiqemi që, sa të kemi mundësi, t'i kryejmë detyrat tona.

Të dashur fëmijë!

Shpresojmë se do ta pëlqeni librin që kemi përgatitur për ju, për ta e lexuar dhe kuptuar Kuranin. Ne u munduam që librin tonë të shenjtë ta bëjmë të njohur për ju dhe t'ju shpjegojmë.

Ta lexojmë librin tonë të bukur dhe të zbukurohemi me leximin e tij. Të gjithë së bashku, të formojmë një botë të lumtur.

Ju jeni e ardhmja jonë, dhe ju ju duam shumë...

BASHKËSIA FETARE E DIJANETIT

MËSOJ LIBRIN TIM



BOTIMET E BASHKËSISË FETARE TË DIJANETIT

ANKARA
2008

Përmbajtja

PJESA E PARË

KRIJESA MË E ÇMUAR ËSHTË NJERIU

- Miku i pritur 9
- Çdo mëngjes dielli lind për ne 10
- Jeta e kësaj bote është një udhëtim 11
- Çdo gjë, na është lënë amanet 12
- Feja është rruga e lumturisë 13
- Nga Ademi a.s. deri tek Muhamedi a.s. 14
- Librat e shenjtë 15
- Kurani fisnik 16

TE LEXOJMË... TREGON SUREN QE KA ZBRITUR
NË EMËR TË BLETËS 18

PJESA E DYTË

TA NJOHIM LIBRIN TONË

- Erdhi një engjëll i tha: Lexo 21
- Libri ynë ka disa emra të bukur 21
- Ajetet zbritën një nga një 22
- Çdo fillim i punës duhet të jetë me bismil-lah 24
- Emrat e sureve 24
- Suret nga Kurani 25
- Xhuzat e Kuranit 26
- Thënia humb, shkrimi mbetet 26
- Bilbilat e Kur'anit-Hafëzët 28
- Hatme: leximi i Kuranit në tërësi 29
- Shkrimi i Kuranit dhe shkruesit në Stamboll 29
- Të lexohet bukur Kurani fisnik 30
- Libër i cili ndikon tek të tjerët 30
- Kurani e thotë të vërtetën haptazi 31

| | |
|---|----|
| • Ai është libër që i nxori njerëzit nga errësira në dritë | 32 |
| <i>TË LEXOJMË ... KY RRËFIM TREGON RRETH SURES QË KA ZBRITUR NË EMËR TË BUBURRECIT.</i> | 34 |

PJESA E TRETË


Ç'FARË KA NË KURANI KERIM?

| | |
|--|----|
| • Çështjet themelore të Kuranit | 39 |
| • Kurani Kerim na mëson kushtet e besimit | 40 |
| • Kurani na mëson ibadetin | 41 |
| • Kur'ani na mëson se si te bëjmë dua | 43 |
| • Kurani na mëson të jemi të moralshëm | 44 |
| • Kurani na mëson hallallin, haramin, të mirën, të keqen, të drejtën dhe të gabuarën | 45 |
| • Kurani i jep rendësi të madhe jetës familjare | 46 |
| • Kurani na mëson të kemi dashuri ndërmjet nesh | 46 |
| • Këshilla për fëmijë nga Kurani | 51 |
| <i>TË LEXOJMË... MERIMANGA SHPJEGON SUREN QË KA ZBRITUR NË EMËR TË SAJ</i> | 53 |

PJESA E KATËRT

MËSIMET QË DUHET T'I MARRIM NGA TREGIMET

| | |
|--|----|
| • Njeriu i parë ishte edhe peygamberi i parë | 57 |
| • Anija e Nuhut | 62 |
| • Kopshti me lule në zjarr | 64 |
| • I bukuri i të bukurve, Jusufi a.s. | 70 |
| • Një foshnjë në ujë; Musa a.s. | 73 |
| • Një peygamber farkëtar: Davudi a.s. | 77 |
| • Peygamberi që fliste me shpendët: Sulejmani a.s. | 77 |
| • Po flet një foshnjë: Isai, i biri i Merjemes | 78 |



PJESA E PARË

KRIJESA MË E ÇMUAR ËSHTË NJERIU

Miku i pritur

Bota jonë është përkatitur për mikun e pritur për një kohë të gjatë. U vendos në orbitën pranë Diellit. Rrotullohej edhe rreth vetes, por edhe pranë Diellit.

Shpejtësia e rrotullimit të Tokës në orbitën e saj dhe përreth Diellit, ishte aq, sa të mundësonte të jetonin mysafirët. Rrotullimi përreth vetit mundësonte krijimin e ditës e natës, e rrotullimi rreth diellit krijimin e stinëve.

Largësia që ishte nga Dielli, ishte e matur. Po të ishte shumë afër, do të digjej çdo gjë dhe do të bëhej hi. Por, edhe po të ishte shumë larg, çdo gjë do të ngrinte.

Atë e kishte rrethuar me një atmosferë, e cila siguronte mbrojtje të plotë nga çfarëdo sulmi që mund të vinte nga jashtë.

Ishte krijuar si konak për jetën kalimtare të mikut të pritur.

E kishte rrethuar me bukuri të tilla magjepsëse, sa që askush tjetër nuk do të kishte fuqi ta bënte atë përveç Allahut.



“Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur”.

Sure: Tin; ajeti 4.



“Ne jemi më afër tij se damari (që rreh) i qafës së tij”.

Sure: “Kaf; ajeti 16.



“Ai është me ju kudo që të jeni”.

Sure: Hadid; ajeti 4.



✨
“Fakt se në krijimin e qiejve e të Tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon All-llahu prej së larti e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj, dhe në të përhap nga çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara në mes qiellit e Tokës, (në të gjitha këto), për popullin që ka mend, ka argumente”

Sure: Bekare, ajeti 164



Nuk kishte lënë asnjë mangësi, çdo gjë ishte menduar deri në detajet më të imëta dhe ishte siguruar gjithçka për mikun që do të vinte.

Pasi që bërë gati gjithçka, më në fund erdhi çasti i pritur.

U lind miku i pritur dhe zbriti në këtë vendqëndrim të bukur.

Ai, nga pamja e jashtme, ishte shumë i bukur.

Ishte ndryshe nga krijesat e tjera.

Kishte intelektin dhe vullnetin. Ishte me ndjenja. Kishte mundësi të mendonte dhe fliste.

Krijuesi, këtij miku i dha shumë rendësi, sepse e donte shumë.

Çdo mëngjes dielli lind për ne

Ekziston vetëm Një Krijues i gjithësisë. E ai është Allahu. Allahu ishte – ekzistonte, edhe kur nuk kishte asgjë tjetër. Allahu krijoi gjithësinë, planetët, yjet, Hënën dhe Diellin. Çdo gjëje i dha jetë.

Allahu, këtë botë e krijoi për ne. Atë e zbukuroi dhe e mbushi me bjeshkë, fusha, dete dhe lumenj. Ai krijoi erën, ujin, dheun dhe ajrin. Krijoi dritën, ngjyrën, zërin. Të gjitha gjallesat: bimët, zogjtë, insektet dhe lulet - i krijoi për ne. Ai krijoi lloje të ndryshme drunjsh në male, me fruta apo pa to. Ai i krijoi lulet me ngjyra të ndryshme; i krijoi edhe bimët. Krijoi të gjitha shtazët, që nga buburreci e deri tek elefanti.

Ndonjëherë sosh pa këmbë, ndonjëherë me katër këmbë, e ndonjëherë edhe me më shumë këmbë. Ai u dhuroi zogjve krahë, në mënyrë që të fluturojnë. Dhe peshqve u dha mundësi të notojnë. I mësoi edhe bletët të bëjnë mjaltin. Të gjitha i krijoi në këtë botë, gjithçka duhej krijuar.

Për faktin se Ai tha “bëhu” është bërë gjithçka

Dielli për çdo mëngjes lind për ne. Mëngjesi gdhin vetëm

për ne. Lumenjtë rrjedhin për ne; lulet në çdo pranverë çelin vetëm për ne; zogjtë na këndojnë këngë. Të gjitha këto janë vetëm për ne. Allahu na do neve shumë. Sado që ta falënderojmë Allahun, është pak për faktin Që na dha shumë rëndësi dhe na do shumë.

Bimë të llojllojshme, shtazë të ndryshme, lule shumëngjyrëshe dhe fruta me shije. Të gjitha këto kanë specifika dhe veçanti të ndryshme. Kur t'i kujtojmë këto, do ta kuptojmë se nuk do të kemi kapacitet t'i kuptojmë të gjitha mirësitë e botës. Dynjaja është shumë e bukur, por njeriu është edhe më i bukur. Dynjaja kaq e bukur është përgatitur për krijesën më të bukur se vetë ajo. Allahu, njeriun e ka krijuar nga më të përsosurat dhe më të bukurat e qenieve (gjallesave).

Ne E besojmë Allahun Që na krijoi nga asgjëja, i Cili na dha këmbë e dorë, sy e veshë dhe na krijoi nga nëna e babai. Sepse, Ai është Një dhe ekziston. Ai ka krijuar çdo gjë, Vetë, pa ndihmën e askujt. Allahu nuk ka lindur dhe nuk e ka lindur askush. Ai nuk ka fëmijë. Për këto as që ka nevojë. Ne Ekzistimin /Qenësinë/ dhe Njësinë e Allahut, se Ai nuk ka ndihmëtar dhe se është i Vetmi Krijues i gjithësisë, e besojmë nga Përgamëri ynë dhe nga libri ynë i shenjtë - Kurani fisnik.

Jeta e kësaj bote është një udhëtim

Ardhja në këtë botë, është hapi i parë i hedhur në këtë botë. Njeriu jetën e tij e jeton etapë pas etape. Rritet ngadalë, zhvillohet dhe plaket. Dita vjen, dhe ai vdes, kështu që ai përmbyll jetën e kësaj bote. Në dallim nga gjallesat e tjera, ai e drejton jetën e tij me anë të mendjes që ia ka dhënë Allahu. Edhe pse njeriu është pronar i mendjes në këtë botë, prapëseprapë ai nuk është lënë i pakontrolluar. Nuk është e mundur që njeriu, përmes orientimit me anë të mendjes në këtë udhëtim të kësaj bote, të arrijë lumturinë. Ai ka nevojë për një udhëzues. Sepse kjo botë, për njerëzit, në të njëjtën kohë është edhe një vend sprovimi.



“Kur Ai dëshiron ndonjë send, Urdhri i Tij është vetëm t’i thotë: “Bëhu!” Ajo bëhet menjëherë.”

Sure: Jasin; ajeti 82



“Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë parregullsi”

Sure: Mulk; ajeti 3.



✨
*“Dhe për ju
 nënshtrori natën
 e ditën dhe
 Diellin e Hënën.
 Edhe yjet janë të
 nënshtruara me
 Urdhrin e Tij.
 Vërtet, në këto ka
 argumente për
 (një) popull që
 mendon.”*

Sure: Nahl; ajeti 12



Sikurse ekzistojnë udhëzues të rrugës së vërtetë të kësaj bote, të tillë ka që edhe të shtrembërojnë prej asaj rruge. Djalli, i cili kundërshton gjithnjë Urdhrat e Allahut, vazhdimisht mundohet t'i mashtrojë njerëzit. Shejtani provon metoda të ndryshme, vetëm e vetëm që t'i pengojë njerëzit që të jetojnë të qetë dhe të lumtur. Ai mundohet t'ua marrë mendjet njerëzve dhe t'ua tregojë si të bukura gjerat e ndyra, t'i largojë nga rruga e drejtë për t'i nxitur që të bëjnë vepra të këqija dhe të ndaluara. Si kundërpërgjigje ndaj një veprimi të tillë (të shejtanit), meqë Allahu i do shumë njerëzit dhe dëshiron që ata të qëndrojnë larg veprave të këqija, Ai dërgon pejgamberë. E pejgamberët u mësojnë njerëzve fenë e Allahut, e cila është rruga e drejtë dhe e lumtur. Po qe se njerëzit u përmbahen këshillave të pejgamberëve, ata jetojnë të lumtur, dhe nëse nuk u shmangen mashtrimeve të shejtanit, në këtë botë dhe në botën tjetër do të jenë shumë të dëshpëruar.

Çdo gjë, na është lënë amanet

Allahu, ne dhe këtë botë të bukur, nuk e ka krijuar kot (pa një qëllim). Ai i ka ngarkuar njerëzit me disa përgjegjësi. Çdo gjë na është lënë amanet: kjo botë, gjallesat dhe jeta jonë.

Në mënyrë që t'i kryejmë këto përgjegjësi, Allahu na ka dhënë intelektin, të menduarit dhe të folurit. Ai na ka dhënë edhe ndjenjën e mëshirës dhe të drejtësisë, në mënyrë që të jetojmë në një botë edhe më të mirë.

Në këtë botë jetojnë shumë qenie/gjallesë, të cilat kanë shpirt sikurse edhe ne, si: bari në livadhe, zogu, insekti, lloje të ndryshme bimësh dhe lule shumëgjyrëshe. Edhe pse jeta e atyre nuk është e ngjashme me jetën tonë, ajo prapëseprapë është jetë, dhe shpirtrat e tyre janë shpirtra. Ja, pra, ne mundohemi që çdo gjallesë me shpirt të mos e ngacmojmë.





*“Feja e pranueshme
tek All-llahu Islami”*

Sure: Ali Imran; ajeti 19



*“E Tij është ç’ka në
qiej e në Tokë, dhe
të gjithë vetëm Atij I
përulen.”*

Sure: Rrum; ajeti 26



Sepse ato janë porosi që na janë lënë neve. Ne jetojmë dhe kemi dobi prej tyre – prej gjallesave të tjera - në atë masë sa na ka mundësuar Allahu, pa e prishur drejtpeshimin e gjithësisë.

Feja është rruga e lumturisë

Ne më së miri na njeh Krijuesi ynë, Allahu xh.sh.. Ai na do ne, dhe ne E duam Atë dhe i duam krijesat e Tij. Ai e di shumë mirë se ç’bëjmë ne që të bëhemi të lumtur apo të pikëlluar. Allahu xh.sh. nuk dëshiron aspak që ne në këtë botë të jemi të pikëlluar. Ai na ka dërguar pejgamberë, që të ruhem nga të këqijat dhe nga veprimet a marra e të jetojmë të qetë dhe të lumtur. Edhe pejgamberët janë njerëz, sikurse ne. Veçse Allahu xh.sh. ata i zgjedh nga mesi i njerëzve. Ata i mbron në mënyrë të veçantë, i mëson dhe i zhvillon. Ata janë të moralshëm, punëtorë, besnikë dhe guximtarë. Ata na e mësojnë fenë e Allahut xh.sh.. Fe do të thotë njohuria e jetës, e cila na mundëson të jemi të lumtur. Feja, së pari, njeriut i tregon rrugën se si të jetë i lumtur me Krijuesin e tij, e më pastaj me vetveten dhe me rrethin e tij.

“Secili popull
kishte të dërguarin
e vet”.

Sure: Junus: ajeti 47

Pejgamberët e
përmendur në

Kuran:

Adem,

Idris,

Nuh,

Hud,

Salih,

Ibrahim,

Lut,

Ismail,

Is'hak,

Jakub,

Jusuf,

Ejjub,

Shuajb,

Musa,

Harun,

Davud,

Sulejman,

Iljas,

Eljesa,

Junus,

Dhulkift,

Zekerija,

Jahja,

Isa dhe

Muhammedi
alejhimus'selam.

Nga Ademi a.s. deri tek Muhamedi a.s.

Allahu xh.sh. u dërgoi pejgamberë njerëzve, ata nuk i la të vetëm. Ademi a.s. ka qenë edhe njeriu i parë, edhe pejgamberi i parë. Është babai i të gjithë njerëzve. Të gjithë e kanë pre-jardhjen nga Ademi a.s.. Të gjithë jemi bij e Ademit a.s., për këtë shkak njeriut i thuhet edhe biri i Ademit. Nga Ademi a.s. e deri tek Muhamedi a.s., kanë ardhur shumë pejgamberë. Pejgamberi ynë, Muhamedi a.s., është pejgamberi i fundit. Pas këtij, Allahu xh.sh. nuk do të dërgojë ndonjë pejgamber.

Ne u besojmë të gjithë pejgamberëve. Të gjithë pejgamberët i duam si pejgamberin tonë. Sepse edhe ata i ka dërguar Allahu. Të gjithë, të njëjtat të vërteta ua kanë predikuar njerëzve. Detyra e tyre është për t'u treguar rrugën e vërtetë njerëzve. Meqenëse Allahu xh.sh. është Një, edhe feja e Tij është e vetme, të cilën në kohët e ndryshme e ka dërguar përmes pejgamberëve. Për këtë arsye, çdo ligji a feje të ardhur nga Allahu xh.sh., i themi Islam, dhe çdo pejgamberi i themi pejgamber i Islamit.

Gjatë historisë njerëzit kanë ndërruar fenë që u është mësuar. Pejgamberi i dërguar nga Allahu xh.sh. njerëzve, me të cilët jetonte, ua ka sqaruar fenë. Mirëpo, ata, pasi kalonte një kohë pas vdekjes së atij pejgamberi, fesë që u kishte dërguar Allahu xh.sh., i bashkëngjitnin mendimet dhe besimet e veta. Në këtë mënyrë njerëzit prishnin fenë e Allahut xh.sh. dhe për këtë shkak, Allahu xh.sh. u dërgonte pejgamber, për t'ua tërhequr vërejtjen atyre. Kjo vazhdoi në këtë mënyrë derisa erdhi pejgamberi ynë, Muhamedi a.s.

Çdo ligj fetar që ka dërguar Allahu xh.sh., në thelbin e tij është i njëjtë. Mirëpo, kur fesë që u është prezantuar njerëzve për të jetuar një jetë sa më të mirë dhe më të lumtur, i ndryshohej thelbi/baza, njerëzit nuk mund të arrinin lumturinë e vërtetë, dhe për këtë shkak njerëzit mbeteshin pa fenë e Allahut xh.sh.

Allahu xh.sh. njerëzve u ka kujtuar gjithmonë të vërtetën dhe të drejtën përmes pejgamberëve, në mënyrë që ata të mos mbeteshin të painformuar për të vërtetën.

Ja, pra, feja jone islame është feja e vetme që nuk është ndryshuar nga ana e njerëzve. Sepse kriteret e fesë sonë janë të shkruara në librin tonë. Edhe libri ynë (Kurani) nuk është ndryshuar aspak deri në ditët e sotme.

Tani do të njohim/mësojmë shkurtimisht librat e shenjtë.

Librat e shenjtë

Pejgamberët janë një urë në mes nesh dhe Allahut xh.sh.. Çdo pejgamber është i dërguar. Të dërguarit ose pejgamberët thënie-t e Allahut xh.sh. i kanë sjellë tek ne. Njohuritë e dërguara nga Allahu xh.sh. tek pejgamberët, quhen Vahj/Shpallje. Vahj d.m.th. ‘lajmi që vjen nga Allahu xh.sh.’ ose Fjalë e Tij. Librat në të cilët janë mbledhur thëniet e Allahut xh.sh., quhen libra të shenjtë. Këta janë libra të dërguar nga Allahu xh.sh. tek pejgamberët e zgjedhur, për t’u rrëfyer njerëzve rrugën e drejtë.

Allahu xh.sh. disa pejgamberëve u ka dërguar libra, e disa të tjerëve u ka dërguar broshura/fletushka prej disa faqesh (sahife).

Sot në botë besohet se nga Allahu xh.sh. kanë zbritur katër libra (të shenjtë), që janë: Tivrati, Zeburi, Inxhili dhe libri ynë - Kurani fisnik. Tivrati dhe Zeburi janë të hebrenjve, Inxhili i të krishterëve, kurse Kurani është libri ynë. Njerëzit që u besojnë librave që kanë zbritur para Kuranit, quhen “Ehli – Kitab:”.

Tivrati

Tivrati është libri i shenjtë i jehudinjve, që i është dërguar Musait a.s.. Ky është libri i shenjtë më i vjetër, për të cilin dihet. Jehud është emërtimi i një feje dhe i një populli. Prandaj jehudizmi është fe vetëm e atyre që janë jehudin. Origjinali i Tivratis që i është dërguar Musait a.s., nuk është ruajtur. Njohuritë dhe tekstet që janë futur në Tivrat, me kalimin e kohës, janë ndërhyrje njerëzore.

Përveç këtyre, në Kuran përmenden edhe emrat e tre personave, për të cilët nuk dihet me siguri nëse janë pejgamberë apo jo: Uzejri, Llukmani dhe Dhulkarnejni.



“*Ne me madhërinë
Tonë e shpallëm
Kuranin dhe Ne
gjithsesi jemi
mbrojtës të tij.*”

Sure: Hixhr; ajeti 9

Zeburi

Zeburi është libri i dytë i shenjtë i jehudinjeve, pas Tevratit. Ai i është dërguar Davudit a.s. Sot një pjesë e tij gjendet në Tevrat. Nuk dihet me saktësi se kur është përmbledhur si libër për herë të parë. *Zeburi* përbëhet nga kapituj, të cilët quhen Psalme - “Mezimir”. Nuk përmban urdhëresa a ndalesa. Është një libër me këshilla, i shkruar në formë të poezisë.

Inxhili

Inxhili (ose Ungjilli) i është zbritur Isait a.s. dhe është libri i shenjtë i të krishterëve. Nuk ishte shkruar gjatë kohës sa ishte Isai në mesin e popullit të tij. Pas ngjitjes së Isait a.s., shumë nga dijetarët fetarë kanë shkruar Unxhij, sipas mendimeve të veta, por ata mbetën pa u mbledhur në një vëllim. Të gjithë i besonin Ungjillit që kishin në duart e tyre, dhe mendonin se ai ishte i vërteti. Kjo çështje delikate, ashtu sikur ishte shkak i polemikave në besim, shpesh u hapte rrugë luftërave të përgjakshme në mes të krishterëve, gjatë gjithë historisë. Dijetarët e fesë së krishterë, për të përballuar këto polemika dhe për të siguruar njëshmërinë/vërtetësinë e librit, 325 vjet pas lindjes së Isait a.s., organizuan një tubim të madh në Nike (Izniku i sotëm, qytet në Turqi). Pas diskutimeve, polemikave dhe debateve të shumta që zgjatën për disa ditë, arritën ta përkufizonin numrin e librave në katër sish. Ungjilli i sotëm përbëhet nga bashkimi i këtyre katër librave në një vëllim.

Kurani fisnik

Kurani është libri i fundit i dërguar nga Allahu xh.sh. tek njerëzit, për t’i udhëzuar në rrugën e drejtë. Libër tjetër i shenjtë pas këtij nuk do të vijë. Ligjet e tij janë të vlefshme deri në Kiamet.

Dallimi më i madh i Kuranit nga librat e tjerë të shenjtë është se ai është shkruar në kohën sa ishte gjallë vetë Muhamedi a.s. Përveç kësaj, Pejgamberi a.s. shumë shokëve të tij ua kishte mësuar Kuranin përmendsh. Kjo traditë e shenjtë ka vazhduar që atëherë për të arritur deri tek ne, e për të vazhduar edhe në të ardhmen. Kur vdiq Pejgambei a.s., në duart e myslimanëve

Kurani ishte i kompletuar dhe i shkruar. Përkundrazi, Tevrati ishte mbledhur e shkruar 700 vjet pas vdekjes së Musait a.s., kurse Inxhili 100-150 vjet pas Isait a.s.


Kuani ka zbritur për të gjitha kohët dhe të gjithë njerëzit, dhe jo për një popull dhe një kohë të caktuar. Allahu i Madhëruar ka garantuar se Ai Vetë do ta ruajë Kuranin deri në Kiamet. Për këtë shkak, askush nuk do të ketë fuqi të ndryshojë qoftë edhe një shkronjë të tij. Sepse ai është një libër i ruajtur.

Përderisa njeriu t'i përmbahet rrugës së Allahut xh.sh., të cilën e ka treguar në Kuran, ai do ta fitojë dashurinë e Tij. Allahu xh.sh. është Ai Që na do shumë dhe meriton të duhet prej nesh. Ai që krijoi njeriun dhe gjithësinë, me dashurinë e Tij, dhe Ai Që në zemrat tona vendosi dashurinë. Mendoni pra, a mund të ketë ndonjë dhuratë më të çmuar sesa të përpiqemi të fitojmë dashurinë e Allahut të Madhëruar, Krijuesit të gjithçkaje, qiejve dhe Tokës, të atyre që i dimë e nuk i dimë. Po, me të vërtetë ne jemi bijtë e qytetërimit të dashurisë.



*“Zoti që më krijoi,
Ai më udhëzon. Dhe
Ai që më ushqen dhe
më jep të pijë. Dhe,
kur të sëmurem, Ai
më shëron.”*

Sure: Shuara; ajetet 78 - 80



“Zoti yt i dha
 instinkt bletës:
 “Ndërto shtëpi
 nëpër kodra (male),
 nëpër drunjt dhe
 nëpër çatitë që ata
 (njerëzit) ndërtojnë.
 Pastaj ha nga
 të gjitha (llojet)
 fruta dhe futu
 nëpër rrugët e
 nënshtruara (e të
 mësuar) prej Zotit
 tënd. Nga barqet
 e tyre (të bletëve)
 del lëng, ngjyra
 e të cilit është e
 ndryshme dhe në
 të cilin ka shërim
 (ilaç) për njerëz.
 Edhe në këtë ka
 arsye për atë popull
 që mendon thellë.”

Sure: Nahl; ajetet 68-69

TË LEXOJMË...

TREGON SUREN QE KA ZBRITUR NË EMËR TË BLETËS

Unë jam bletë e vogël mjalti. Unë jam nga miliona e miliardë krijesat më të vogla të kësaj bote të madhe, të krijuar nga Allahu xh.sh..

Në librin e shenjtë të fundit që ka dërguar Allahu xh.sh. për njerëzit, mua më është dhënë një pjesë dhe rëndësi e veçantë, dhe në të është rrëfyer rreth meje. Edhe Muhamedi a.s., sipas Urdhrit të Allahut xh.sh., në Kuran një sure ka emërtuar me emrin tim. Kur mësova për këtë, u bëra shumë e lumtur.

Në këtë sure, Allahu i Madhëruar mua më mësoj se si të bëj një koshere, si të formoj hoje, si të shkoj në largësi të madhe edhe disa kilometra, pa e humbur rrugën, deri në lulet më të bukura dhe për të marrë nektarin, në mënyrë që të bëjë mjaltë.

Edhe ne pajtohemi me këtë urdhër dhe, sipas një plani të përsosur gjeometrik dhe matematikor, jemi në lëvizje. Së pari ndërtojmë hojen dhe dhomëzat e saj në mënyrë të përsosur, për të vendosur mjaltin. Pastaj, pas mundimeve të lodhshme që bëjmë nëpër lulet e ndryshme, lëngun e nektarit që e marrim atje, me mundin dhe trupin tonë, e shndërrojmë në mjaltë. Pastaj këtë mjaltë e vendosim me mjeshtëri në çdo korridor të hojes Këtë punë e kryejmë së bashku me bletët e tjera, me tërë forcën tonë, pa bërë gabime.

Ne punojmë ditë e natë pandërprerë, sikurse na ka mësuar Allahu xh.sh., për ta bërë mjaltin, që është edhe burim i shërimit dhe me shije të ëmbël. Ne do të vazhdojmë të punojmë pandërprerë derisa të marrë fund kjo botë.

Zoti i Madhëruar, duke na dhënë shembuj, neve na tregon se asgjë në këtë botë nuk është krijuar pa ndonjë qëllim, ashtu kot dhe pa ndonjë vlerë. Ai kërkon nga ne që të vështrojmë duke drejtuar shikimin tonë nga lisat, zogjtë, lulet shumëngjyrëshe, lumenjtë, qiejt dhe yjet, dhe të kuptojmë se Fuqia e Tij është absolute. Ai pret nga të gjithë ne që, pa e prishur sistemin e bukur të kësaj bote, të rrisim lumturinë. Mundësisht të mos e harrojmë këtë.



Shpresojmë që ju të interesoheni për këtë e të hulumtoni rreth këtyre dhe, sa herë t'i shihni bletët, të rikujtoni këto fjalë.

Në rregull, po a thua ju në ç'masë duhet t'u përmbaheni Urdhrave të Allahut xh.sh.? A keni menduar ndonjëherë për këtë? Për këtë shkak, së pari duhet të lexoni shumë Kuran. Vetëm në suren ku përmendet emri im, ka shumë çështje. Ejani ta lexojmë këtë sure.

Sigurisht se keni dëshirë ta dini emrin e sures ku përmendet emri im? Atëherë, po e them menjëherë. Sureja "Nahl" - e ka marrë emrin nga unë. Nahl d.m.th. bleta e mjaltit. Kjo është surja e 16 në Kuran.

Surja Nahl ka 128 ajete. Në këtë sure shpjegohet se bukuritë e qiejve, të Tokës dhe të të gjitha ekzistencave që janë në ato janë në harmoni të poërbashkët dhe që duhet t'u shërbejnë njerëzve.

Në këto ajete ceket dhe kërkohet nga njerëzit që të logjikojnë rreth këtyre dhe ta njohin Allahun xh.sh. e t'i bëjnë Atij ibadet. Përkujtohet se çfarë do të jetë përfundimi i atyre që mohojnë, qëllimin e zhdritjes së Kur'anit dhe rëndësinë e përdorimit të mendjes dhe të meditimit.

Shkurtimisht, temat themelore të cilat theksohen në këtë sure janë temat e: besimit, mohimit, drejtësisë, mirësisë, të menduarit, mendjes, premtimit, diturisë, durimit dhe devotshmërisë.

Nuk dua ta përfundoj fjalimin tim pa ju treguar edhe këtë çështje, e cila m'u kujtua tash. A e dini se me sa ndjeshmëri sillej Muhamedi a.s. me të gjitha krijesat? Ai, madje edhe në çastet e luftës, u kishte thënë shokëve të tij: "Mos i vritni kafshët, mos i dëmtoni pemët/drunjtë dhe as bimët e tjera. Mos i sulmoni fëmijët, gratë, pjestarët e feve tjera derisa bëjnë ibadet, dhe tempujt e tyre." Sa shumë që ka nevojë për këto fjalë të arta bota në të cilën jetojmë ne sot. Kur i dëgjova këto, unë u emocionova shumë. Si të mos emocionohesha, kur një peygamber, i cili është dërguar mëshirë për mbarë botën, një krijese të vogël siç jemi ne, po i jep kaq shumë rëndësi dhe po i porositi njerëzit që të sillen sa më mirë me ne.

PJESA E DYTË

TA NJOHIM LIBRIN TONËM

Erdhi një engjell i tha: lexo

Allahu xh.sh., Pejgamberit a.s. ajetet e para të Kuranit ia shpalli në shpellën Hira të bjeshkës Nur. Xhebraili ia solli atij pesë ajetet e para të sures “Alek”, që fillojnë me urdhrin “Lexo”.

Shpallja/Vahji për herë të parë i kishte ardhur Pejgamberit a.s. kur ishte në moshën 40 vjeç. Ishte muaji Ramazan, muaji në të cilin agjërojmë. Nga ditët ishte dita e hënë. Kjo ngjarje, e cila ndodhi në vitin 610, ishte fillimi i Vahjit, i cili vazhdoi derisa vdiq Pejgamberi a.s.. Nata kur ka filluar të zbresë Kuranin, quhet Nata e Kadrit. Këtë natë myslimanët e kalojnë dhe e festojnë duke bërë ibadet dhe lutje.

Libri ynë ka disa emra të bukur

Kurani Kerim, është libri leximi i të cilit është ibadet.

Furkan, që ndan të vërtetën nga gënjeshtra, nga e pavërteta, dhe të mirën nga e keqja.




*“Kur të lexohet
Kurani, ta dëgjoni
(me vëmendje)
dhe të heshtni, në
mënyrë që të fitoni
mëshirë.”*

Sure: Araf; ajeti 204






 “ Është e vërtetë
 se ky Kur’an
 udhëzon për atë
 rrugë që është
 më se e vërteta,
 e besimtarët që
 bëjnë vepra të mira
 i përgëzon se ata
 pa dyshim do të
 kenë shpërblim të
 madh?.”

Sure: Isra; ajeti 9



Nur, do ta ndriçojë rrugën e njerëzimit deri në Kiamet.

Shifa, do t’i shërojë të gjitha problemet morale.

Huda, nuk do të na lejojë ta humbim rrugën edhe në rrugët më të rrezikshme.

Dhikr, nuk do të lejojë që njeriu ta harrojë Krijuesin e tij dhe vetveten.

Kelam, është Fjalë, thënie e Allahut xh.sh.


Ajetet zbritën një nga një

Çdo fjalie në Kuran, i thuhet ajet. Ajetet ndonjëherë prbëhen nga disa shkronja e nganjëherë janë të gjata, sa një faqe libri. Në Kuran ka 6236 ajete.

Pejgamberit a.s. Kur’ami nuk i ka zbritur përnjëherë, por i ka zbritur pjesë-pjesë. Disa ajete në përgjithësi zbritnin pas një ndodhjeje të caktuar, dhe sillnin sqarime për atë ngjarje. Kjo periudhë ka zgjatur për gjithsej 23 vjet. Kjo është bërë në mënyrë që të kuptoheshin sa më mirë mësimet/njohuritë e Kuranit. Edhe Kurani ka zbritur pjesë – pjesë, ashtu sikur rritemi dhe ne dita - ditës, sikur ndërfaqë një shtëpi ndërtohet tulla - tulla, ose, ashtu sikurse zhvillohet një fidan dalëngadalë.

Pejgamberi a.s. 13 vjet të Pejgamberisë i kishte kaluar në Mekë, kurse 10 të tjerët në Medinë. Për këtë shkak, ajetet që i kanë zbritur kur Pejgamberi a.s. ishte në Mekë, quhen mekase, kurse ato që i kanë zbritur në Medinë, quhen medinase. Ajetet e Kuranit që kanë zbritur në Mekë, më së shumi trajtojnë normat e Imanit/besimit, të Ahiretit dhe normat që kanë të bëjnë me moralin. Kurse ajetet që kanë zbritur në Medinë, në përgjithësi flasin rreth çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtën familjare dhe shoqërore.

Pjesët që përbëhen nga ajetet, quhen sure (kaptina). Në Kuran janë 114 sure. Edhe suret, sikurse ajetet, ndonjëherë janë të gjata e ndonjëherë janë të shkurtra. P.sh. surja “Bekare”





mbush 48 faqe ose ka 286 ajete. Kjo është surja me e gjatë e Kuranit. Përkundrazi, në Kuran ka dhe një sure me vetëm një rresht. P.sh. surja “Kevther” është vetëm një rresht. Në këtë mënyrë ajetet i formojnë suret, kurse suret e formojnë Kuranin.

Çdo fillim i punës duhet të jetë me bismil-lah

Të gjitha suret e Kuranit, përveç njërës, fillojnë me Bismil-lah. Ashtu sikurse kur fillojmë ta lexojmë me bismil-lah, po ashtu me bismil-lah e fillojmë edhe çdo punë ditore. Besmelja thuhet “Bismil-lahi Rrahmani Rrahim” apo shkurtimisht “Bismil-lah”. Ka kuptimin “Me Emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirbërësit”. Kur të fillojmë një punë me bismil-lah, Allahu xh.sh. do të na ndihmojë dhe do të na e lehtësojë atë punë. Gjithmonë duhet të themi bismil-lah, kur të nisim të hamë bukë, kur të nisemi në shkollë, kur të nisim të mësojmë ose kur të biem për të fjetur. Besmelja nuk duhet të mungojë asnjëherë në gjuhën e myslimanit. Dyqanet hapen me besmele dhe me besmele dilet në rrugë dhe merret çdo udhëtim. Besmelja është një nga themelet kryesore të kulturës sonë.

Emrat e sureve

Çdo sure e Kuranit ka nga një emër. Suret ndonjëherë janë emërtuar me emrat e peygamberëve, si: Ibrahim, Jusuf apo Muhammed; ndonjëherë me emrat e trupave qiellorë, si: Yll (Nexhm), Hëna (Kamer), Diell (Shems); ndonjëherë me shkronjat e para të tyre, si: Taha, Jasin, Kaf, Sad apo Nun; ndonjëherë janë emërtuar me emrat e ndodhive të Pejgamberit, si: Isra, Muxhadele dhe Huxhurat; ndonjëherë me emrat e njerëzve, si: Insan, Nas, Nisa dhe Merjem; ndonjëherë nga rrethi, si: Xhinn, Munafikun apo ndonjëherë nga jeta e Ahire-





tit, si: Kijame, Nebe dhe Tekvir, e ndonjëherë edhe me emrat e insekteve, si: Bleta (Nahl), Marimanga (Ankebut), Buburreci (Neml). Një sure tjetër e ka marrë emrin nga një bimë Fiku (Tin).

Suret nga Kurani

Besmelja është çelësi i Kuranit, kurse surja Fatiha është dera e tij. Fatiha d.m.th. hapës ai që hap diçka. Kjo sure është thelbi i Kuranit. Në këtë sure shpjegohet se lavdërimi dhe madhëria i takojnë vetëm Allahut xh.sh. dhe se vetëm nga Ai kërkohet ndihmë dhe vetëm Atij i bëhet ibadet.

Surja Fatiha është nga suret që e lexojmë më së shumi në jetën e përditshme, në lutje dhe në namaz. Në fund të lutjeve këndojmë Fatihanë. Edhe për shpirt të të vdekurve, për të cilët lutemi, e këndojmë po këtë sure.




“Thuaj: Ai, All-llahu është Një! All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s’ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë me Të”.

Sure Ihlas






*Me emrin e All-
 llahut, Mëshiruesit,
 Mëshirëbërësit!
 Falënderimi i takon
 All-llahut, Zotit të
 botëve!
 Mëshiruesit,
 Mëshirëbërësit!
 Sunduesit të
 Ditës së Gjykimit
 (përgjegjësisë-
 shpërblimit)!*
*Vetëm Ty Të
 adhurojmë dhe
 vetëm prej Teje
 kërkojmë ndihmë!
 Udhëzونا
 (përforcona) në
 rrugën e drejtë!
 Në rrugën e atyre,
 të cilët i begatove
 me të mira, jo në
 të atyre që kundër
 vetes tërhoqën
 hidhërimin, e as
 në të atyre që e
 humbën veten!*

Sure Fatiha



Nga suret e Kuranit, që e lexojmë më së shumi pas Fatihasë, është surja Ihlas. Ihlas d.m.th. të jesh i singertë dhe të sillësh në përputhshmëri me normat fetare. Në këtë sure Allahu xh.sh. E tregon Vetën në mënyrën më të hollësishme. Për këtë arsye, kjo sure është rrënja – thelbi i tevhidit / Njëshmërisë.


Nga suret e Kuranit që e lexojmë më së shumi, është edhe surja Jasin. Është pranuar se Jasin do të thotë “O njeri”. Kjo sure llogaritet si zemra e Kuranit. Është nga suret që lexohet më së shumi nga myslimanët. Veçanërisht kjo ndodh në ditën e Xhuma dhe në vizitat që u bëhen varrezave. Në këtë sure tregohet argumentet që shprehin parimet e besimit Islam, Njëshmërinë dhe fuqinë e Allahut, dhe temat siç janë: krijimi i njeriut dhe ngjallja pas vdekjes.

Xhuzat e Kuranit

Libri ynë, Kurani, përveç ajeteve dhe sureve, është ndarë edhe në xhuza / pjesë. Kjo ndarje na mundëson lehtësim gjatë leximit të Kuranit. Çdo faqeje të 20 nga fillimi, i thuhet xhuza. Në çdo fillim të xhuzit, në qoshe të faqes, na pret një figurë luleje. Këtyre luleve u thuhet - lulet e xhuzave. Kur dikush përfundon leximin e një xhuze, së pari do të takojë këtë lule në fillimin e xhuzit tjetër. Në këtë mënyrë në Kuran ka 30 xhuza me lule.

Thënia humb, shkrimi mbetet

Pejgamberi a.s. Shpalljen që e merrte nga Allahu xh. sh. pjesë - pjesë, së pari ua jepte ta shkruanin myslimanëve që dinin shkrim-leximin. Personat që kanë shkruar Kuranin, quhen Shkruesit e Shpalljes. Detyra e tyre ishte që të shkruanin çdo ajet që zbriste. Çdo ajet që i shpallej Pejgamberit a.s., pa asnjë gabim e të metë, shkruhej nga ata persona. Ndër ta kanë qenë edhe Ebu Bekri, Omeri, Osmani, Aliu dhe Zejd ibn Thabit, Al-





lahu qoftë i kënaqur me ta. Nga mundi dhe sinqeriteti i atyre njerëzve dhe të tjerëve, Kurani u shkrua dhe deri tek ne arriti pa asnjë ndryshim dhe gabim.

Pas Pejgamberit a.s., udhëheqës i myslimanëve pati ardhur Ebu Bekri r.a.. Në kohën e tij Kurani, me iniciativën e Hz. Omerit, u mblodh në një libër. Në këtë mënyrë, Kurani është shkruar me dëshminë e hafëzëve dhe është mbledhur në një vëllim, i cili është quajtur Mus'haf. Ky Kuran mbahej në duar të Ebu Bekrit r.a. deri në vdekjen e tij. Nga Ebu Bekri r.a. pati kaluar tek Omeri r.a. e, pas vdekjes së këtij, kishte kaluar tek e bija e tij, njëherësh edhe bashkëshortja e Pejgamberit, - Hz. Hafsa, kurse prej saj pati kaluar tek Osmani r.a..

Në periudhën e Osmanit r.a., kufijtë e shtetit islam qenë zgjeruar shumë. Shumë njerëz e popuj patën pranuar Islamit. Në këtë mënyrë ishte rritur numri i myslimanëve dhe sipërfaqja e tokave që zotëronin ata. Për këtë arsye, lindi nevoja që në të katër anët e shtetit islam të dërgohej nga një Kuran. Për ta kryer këtë detyrë dhe për të shumëzuar Kuranin, për bazë është marrë Kurani që ishte shkruar në kohën e Ebu Bekrit. Kuranët u dërguan në 7 qytete të mëdha të shtetit islam. Kurani që kemi sot në shtëpitë tona, është kopje e atij.

Bilbilat e Kur'anit-Hafëzët

Ata që e mësojnë Kuranin përmendsh, të tërin, quhen hafëzë. Hafëzllëku është një punë shumë me vlerë. Për shkak se hafëzët e mësojnë Kuranin që nga fillimi e deri në fund, atyre u thuhet “Kurani që ecën”. Disa prej nesh, në vend të kësaj përdorim shprehjen “Kurani që jeton”. Në të vërtetë, atyre mund t’u themi edhe “Kurani i gjallë”.

Sot, gati në çdo lagje ka një hafëz, i cili e di Kuranin përmendsh. E nëse nuk ka hafëz, së paku është dikush që di të lexojë ashere. Lexim i asheres është leximi i një pjese nga

Kurani. Kur dikush nga të moshuarit tanë thotë: “Lexo një ashere, ta dëgjojmë”, ai do të thotë që të lexojmë një pjesë nga Kurani përmendesh. Në këtë mënyrë, çdo pjesë që mësojmë nga Kurani, quhet ashere.

Hatme: leximi i Kuranit në tërësi

Hatme do të thotë ta lexosh Kurandin në tërësi, që nga fillimi e deri në fund. Pejgamberi a.s. në muajin Ramazan ia lexonte Xhibrilit të gjitha ajetet që i kishin zbritur deri në ato ditë. Në këtë mënyrë, Pejgamberi a.s. dhe meleku që ia kishte shpallur Kurandin, për çdo vit këndonin Kuran së bashku. Pejgamberi lexonte e meleku e përcillte, dhe, meleku e lexonte, e Pejgamberi e dëgjonte. Leximi në këtë mënyrë, quhet Mukabele. Ja, pra, kjo praktikë, ishte një faktor i rëndësishëm edhe për formimin e traditës së Mukabeles edhe për ardhjen e librit të shenjtë Kuranit deri në ditët tona pa pësuar kurrfar ndryshimi.

Ky edhe është shkaku që i kushtojmë rëndësi të veçantë këndimit të hatmes në muajin Ramazan. Për një përkujtim të bukur në muajin Ramazan, kur agjërojmë, ne e lexojmë dhe e bëjmë hatme Kurandin, që nga fillimi e deri në fund.

Shkrimi i Kuranit dhe shkruesit në Stamboll

Kurani fisnik është më i përsosuri libër nga të gjithë librat e tjerë. Nuk ka libër më të bukur dhe të përsosur sikur ai. Është më i bukuri për thëniet. Nuk ka thënie më të mira e më të bukura se thëniet e tij. Ne myslimanët, përpiqemi ta lexojmë sa më mirë. Dhe për këtë ndiejmë lumturi të madhe.

Në fillim në Kuran nuk kishte shenja të pikësimit dhe as zanore. Me përhapjen e Islamit dhe me rritjen e numrit të mys-




Pejgamberi a.s. thotë: Më i miri nga ju është ai që e mëson Kurandin dhe ua mëson të tjerëve.

(Buhari, Fedailul Kur'an, 21)






Pejgamberi a.s.
urdhëron:
“Islami është
ndërtuar mbi pesë
shtylla; Se nuk ka
Zot tjetër përveç
Allahut dhe se
Muhamedi është
rob dhe i dërguar
i tij, thënia e
Shehadetit, falja e
Namazit, dhënia e
Zekatit, agjërimi
i Ramazanit dhe
kryerja e Haxhit.”

Buhari, “Iman”, 2



limanëve në botë, vëllezërit e rinj myslimanë, të cilët kishin filluar ta pranonin Islamin, u ballafaquan me këto vështirësi në lexim. Për ti eliminuar këto vështirësi, më pastaj u vunë shenjat e pikësimit, të cilat e bënë më të lehtë leximin e tij.

Të lexohet bukur Kurani fisnik

Edhe leximi i bukur i Kuranit, është një art në vete. Një njeri, i cili e lexon Kuranin me zë të bukur, të gjithë i bën të lumtur. Pa dyshim, ne të gjithë kështu nuk mund të lexojmë. Neve na takon që të përpiqemi ta lexojmë sa më mirë, sa më me saktësi dhe sa më bukur që të mundemi.

Para se të fillojmë leximin e Kuranit, së pari marrim abdest, pastaj themi “Eudhu bil-lahi mineshejtani’rraxhim Bismil-lahi Rrahmani Rrahim”. Kështu, kur ta e lexojmë Kuranin dalëngadalë dhe bukur, ne zbukurohemi nga bukuria e tij.

Libër i cili ndikon tek të tjerët

Pejgamberi a.s. çdo natë në shtëpinë e tij në Mekë lexonte Kuran me zërin e tij të bukur. Kurani Kerimi ndikonte aq shumë tek njerëzit, sa që kishte nga mushrikët që natën afroheshin për ta dëgjuar atë. Një natë, tre persona të Mekës (veç e veç) që ishin me autoritet, kishin ardhur për të dëgjuar Kuran. Tek po ktheheshin në shtëpi, u takuan në rrugë. Assesi nuk mund t’i tregonin njëri - tjetrit se kishin ardhur për të dëgjuar Kuran. Mirëpo realitetin e kishin kuptuar që të gjithë. Nuk ishte diçka që mund të bëhej: edhe të vije për të dëgjuar Kuran, edhe ta mohojë atë. Po t’i kishte hetuar dikush, çfarë shpjegimi do t’i jepnin ata? Ose ata i kishin premtuar njëri - tjetrit që, nëse do t’i vërente dikush, të mos vinin edhe një herë tjetër për të dëgjuar. Mirëpo, natën tjetër, nuk mund të qetësoheshin (pa dëgjuar Kuran) dhe erdhën përsëri të dëgjo-



nin. Në këtë mënyrë Kurani ndikonte në thellësitë e zemrave të atyre që e mohonin.

Kurani e thotë të vërtetën haptazi

Kurani është një libër të cilin mund ta e kuptojnë të gjithë. Leximi i tij është i lehtë; leximi, mësimi dhe kuptimi i tij bëhen shumë më lehtë. Atë që na thotë Libri ynë neve, e thotë shumë qartazi dhe në mënyrë të kuptueshme. Veçoria me thelbësore e Kuranit është se ai lexohet dhe mësohet përmendsh shumë lehtë. Nuk ka një libër tjetër në botë që ta këtë veçori.

Ndonjëherë Kurani na tregon disa ngjarje, në mënyrë që t'i kuptojmë disa gjëra sa më lehtë. Këto janë ngjarje nga të cilat duhet të marrim shembull dhe të cilat na japin këshilla.

Ndonjëherë e kemi vështirë t'i kuptojmë disa ajete. Në përgjithësi, në këto ajete janë përdorur stile letrare të ndryshme. Ata që nuk i dinë këto stile, e kanë të vështirë t'i kuptojnë disa ajete. Atëherë i shikojmë librat e tefsirit. Librat e tefsirit janë librat që na e komentojnë Kurantin. Ekziston edhe përkthimi. Përkthimi bëhet në shumë gjuhë të ndryshme. P. sh., përkthimit të Kuranit në gjuhën tonë, i themi- Përkthimi i Kuranit në gjuhën shqipe. E tefsiri i sqaron ajetet në mënyrë më të hollësishme.

Librat e tefsirit janë që na mundësojnë të mësojmë më hollësisht qëllimin e një ajeti, se ç'do të na thotë dhe ç'na mëson ajeti konkret. Nëse duam të lexojmë vetëm përkthimin, atëherë duhet t'i kërkojmë përkthimet. Në namazet që falim çdo ditë, shpesh e lexojmë "Fatihanë", ajetin Elhamdulil-lahi rabbil alemin, dhe mund të shohim në përkthim dhe të mësojmë se e ka kuptimin "Falënderimet janë vetëm për Allahun xh.sh.". Mirëpo, po të interesohemi për të mësuar qëllimin dhe hollësitë e këtij ajeti, atëherë do të na duhet t'u drejtohem librave të tefsirit. Sepse aty ka më shumë shpjegime.



"Kur të lexosh Kurantin, kërko mbrojtjen e Allahut prej djallit të mallkuar."

Sure: Nahl; ajeti 98





Ai është libër që i nxori njerëzit nga errësira në dritë

Kurani njerëzimin e thërret për gjërat që janë më të saktat dhe më të drejtat. Ata që u përmbahen thënieve dhe këshillave të tij, arrijnë të fitojnë dritën e pafund të Islamit, kështu që qëndrojnë larg padrejtësive, zullumeve ose edhe sjelljeve të këqija të njerëzve, që nuk përputhen me normat islame. Përmes rrugës islame, njerëzit bëhen mbrojtës të jetimëve, të të varfërve etj.. Kurse egoistët dhe ata që frikësohen të japin diçka për të tjerët, mund të shpëtojnë nga idetë e tyre vetëm përmes udhëzimit të tij.

Ata myslimanë që jetojnë dhe u përshtaten normave kurano-re, kanë parasysh të drejtat e fqinjëve. Përmes rrugës që tregon Kurani, njerëzit vrapojnë pas fitimit hallall dhe as që ndoten me harame, gënjeshtër e mashtrime. Ata, në vend që të gënjejnë, flasin drejt; në vend që të bëhen dyfytërësh, bëhen bujarë; në vend që të mburren, bëhen zemërbutë dhe në vend që të bëhen egoistë, bëhen bujarë.

Gratë, të cilave më përpara nuk u kushtohej fare rëndësi, me Islamin gëzuan të drejtat dhe liritë e tyre. Njerëzit e kuptuan se vajza a djali që lindin me gruan, janë një dhuratë nga Allahu. Njerëzimi, përmes Islamit e mësoi se si të bëhen të durueshëm ndaj pengesave që u shfaqen, që t'u ndihmojnë grave dhe me to të jetojnë fitimtarë në bashkësi. Islami i dha një dritë njerëzimit dhe robërve që më herët ndiheshin të turpëruar, por edhe u dha liritë e tyre në jetë.

Kurani mbi njerëzimin lindi sikurse një diell ndriçues. Përmes tij, errësira u bë dritë, vendet e këqija u shndërruan në rahatit dhe nur. Bashkë me të erdhën edhe siguria, e drejta





njerëzore, lumturia, qetësia, liria etj.. Me të u rrit edhe numri i njerëzve të qytetëruar.

Kurani Kerimi i mësoi njerëzit të qëndrojnë larg të këqijave.

Kurani Kerimi i mësoi ata që të jetojnë në bashkësi.

Kurani Kerimi u mësoi atyre shoqërinë dhe vëllazërinë.

Kurani Kerimi u mësoi atyre dashurinë dhe lirinë.

Kurani Kerimi njerëzimit i mësoi qytetërimin.





TË LEXOJMË ...

KY RRËFÏM TREGON RRETH SURES QË KA ZBRÏTUR NË EMËR TË BUBURRECÏT.

E dini se Allahu i Madhëruar Muhamedit a.s. i ka shpallur ajete. Këto ajete janë mbledhur në Kuran. Ja, pra, në suren Neml, na tregohet ngjarja e buburrecave me Sulejmanin a.s..

Po ju rrëfej juve rreth vetes sime. Unë jam një buburrec i vogël. Meqë Allahu më ka përmendur në Kuran, mua më ka dhënë shumë vlerë. Për këtë shkak, nuk arrij dot ta shpreh se sa i lumtur që jam. Përveç kësaj, ne jemi nga insektet që Allahu e ka bërë haram të na mbytni. Madje Allahu nuk ka lejuar që të ndizet zjarr pranë çerdheve tona.

Nëse dëshironi, së pari të gjithë së bashku të mundohemi ta njohim suren e 27, suren Neml të Kuranit. Kjo sure ka 93 ajete. Në fillim flet rreth këtyre çështjeve: rëndësia e besimit në Allahun dhe e ibadetit ndaj Tij; besimi në Shpalljen / vahjin; gjërat që nuk mund t'i shohim, nuk mund t'i dimë, por që i di Allahu; të dimë se furnizues i çdo gjëje është vetëm Allahu dhe se për këtë duhet ta falënderojmë. Tregohet për ngjarjet e Sulejmanit e Belkizes dhe rreth përjetimeve të Pejgamberëve Musa, Salih dhe Lut alejhimus selam. Ja pra, të gjitha këto tregohen në suren Neml, e cila e ka emrin tim. Disa njerëz, edhe pse shohin dhe dëgjojnë ndodhi të ndryshme me plot mësim dhe ngjarje, prapëseprapë nuk E besojnë Allahun. Kur i mendoj këto, E falënderoj shumë Allahun.

Para se t'ju tregoj për ngjarjen e Sulejmanit, do t'ju rrëfej rreth ndodhive të buburrecave. Jam i sigurt se do të habiteni gjatë leximit.



Ne buburrecat ndahemi në tri lloje: mbretëreshë, punëtorë dhe meshkuj. Çdo lloj yni lind duke ditur punën e tij. Ne nuk kemi nevojë sikur ju për shkollim, studim, provim apo diplomë. Sepse Allahu na i mëson këto vetiu.

Pavarësisht se jemi shumë të vegjël, Allahu i Madhëruar na ka dhënë shumë specifika: të jemi të drejtë, të llogarisim në mënyrën më të hollësishme, të bëjmë pjesë të punëve apo punë. Kushtet e jetës sonë janë shumë të vështira. Bartja e një kokrrë grur deri në çerdhen tonë, mund të na marrë orë të tëra. Për këtë shkak Allahu i Madhëruar ka dashur që të jetojmë në koloni të mëdha, prej qindramijëra buburrecash. Edhe ne na ka zbukuruar dhe pasuruar me bukuri të veçanta, sikurse edhe gjallesat e tjera, dhe na ka mundësuar harmoni të mirë në vendin ku jetojmë.

Ne, çerdhet tona i ndërtojmë nën tokë dhe atyre u bëjmë lidhje të shumta me njëra-tjetrën. Sepse ka shumë gjëra që na sulmojnë. Këto, ndonjëherë janë njerëzit e ndonjëherë edhe shiu. Meqë nuk dimë të notojmë, në ujë humbim menjëherë. Ah, edhe ata njerëz që, ndonjëherë me dije e ndonjëherë pa dije, na shkelin! Por, nëse vetëm pakëz bëhen të kujdesshëm ata kur ecin, ne nuk do t'i përjetonim këto vështirësi. Kërkojmë nga ju të bëheni më të kujdesshëm.

Tani t'i kthehemi ngjarjes. Allahu i Madhëruar shumicën e shpendëve i ka vënë në shërbimin e Sulejmanit a.s., shumë nga krijesat i shërbenin atij; era e dërgonte në vendin ku dëshironte, zogjtë i sillnin informata, bjeshkët bashkë me të E kujtonin Allahun xh.sh.. Allahu Sulejmanit a.s., përveç pejgamberllëkut, i pati dhënë edhe shumë njohuri, si sundimin, depot dhe mundësinë për ta kuptuar gjuhën e zogjve dhe shumë gjallesave të tjera. Edhe pse posedonte këto aftësi, ai asnjëherë nuk mburrej. Sepse ai e dinte që këto janë dhuratë

❦

*“Deri atëherë kur
arritën mbi luginën
e buburrecave,
buburreci tha: “O
ju buburreca, hyni
në vendet tuaja, që
të mos u copëtojë
Sulejmani dhe
ushtria e tij, duke
mos ju vërejtur”
E ai (Sulejmani)
buzëqeshi i gëzuar
prej fjalës së tij,
dhe tha: “Zoti im,
më mundëso t’i
falënderoj të mirat e
Tua që m’i dhurove
mua dhe prindërve
të mi, dhe që të bëj
vepra të mira të cilat
i pëlqen Ti, dhe, me
mëshirën Tënde,
më fut në mesin
e robërve të Tu të
mirë!”.*

Sure: Neml; ajeti 18 - 19








nga Allahu xh.sh.. Ai ishte aq shpirtmirë dhe mëshirëmadh, saqë, kur kalonte në anën tjetër të rrugës, ruhej të mos i shkelte buburrecat.

Sulejmani a.s. bënte dua për vetveten dhe familjen e tij. Ai kërkoi nga Allahu që t'i mundësonte disa punë, me anë të të cilave do të kishte mundësi për të fituar dashurinë e Tij dhe që ta e fuste në Xhenet atë dhe familjen e tij, pranë njerëzve të mirë.

Kjo sure na tregon që të gjitha krijesat dhe gjallesat në këtë botë, E respektojnë dhe nderojnë Allahun. Atëherë, pra, njerëzit duhet ta dinë se nuk janë të krijuar kot në këtë gjithësi dhe nuk kanë të drejtë të sulmojnë as gjallesë tjetër. Ata nuk duhet të harrojnë se kërkohet që në këtë botë të jetojnë së bashku me të gjitha gjallesat e tjera: me buburrecat, bletët, zogjtë, merimangën etj.



PJESA E TRETË
**Ç'FARË KA
NË KURANI KERIM?**

Çështjet themelore të Kuranit

Çështja kryesore e Kuranit është Allahu dhe njeriu. Ai na informon për Allahun, njeriun, ekzistencën dhe obligimet tona fetare. Neve na udhëzon dhe na tregon rrugën se ç'kemi obligim ndaj Allahut, vetvetes, nënës dhe babait, familjes, të gjithë njerëzve, të gjitha gjallesave dhe mjedisit. Kurani Kerim njerëzit i udhëzon për çdo çështje. Nga ne kërkon t'i bindemi Allahut dhe Pejgamberit të tij.


Në Kuran ka shumë ajete që kanë të bëjnë me shumë çështje, si me çështjet e besimit, pastaj përveç normave të ibadeteve dhe moralit, aty janë ngrënia, pirja, martesë apo çështjet ekonomike dhe sociale, që kanë të bëjnë me marrëdhëniet midis njerëzve. Përveç kësaj, ai rrëfen për disa ngjarje të pejgamberëve dhe për ndodhitë e popujve që ishin para nesh, por edhe kërkon nga njerëzit që ata të marrin mësim prej atyre ndodhive.



“Adhuroni All-llahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send, silluni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve, ndaj fqinjit të afërt, ndaj fqinjit të largët, ndaj shokut pranë vetes, ndaj udhëtarit të largët dhe ndaj robërve. All-llahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet.”

Surja Nisa, ajeti 36




 “O ju që besuat,
 nuk bën të tallet
 një popull me
 popullin tjetër,
 meqë të përqeshurit
 mund të jenë më
 të mirë nga ata
 që përqeshin dikë
 tjetër, e as gratë me
 gratë e tjera, sepse
 mund të ndodhë
 që gratë e tjera të
 jenë më të mira se
 ato që përqeshin
 (duke e nënçmuar
 njëra-tjetrën) dhe
 mos etiketoni njëri-
 tjetrin me llagape.
 Pas besimit është
 keq të përhapet
 llagapi i keq. E ata
 që nuk pendohen,
 janë mizorë.”

Sure: Huxhurat; ajeti 11



Kurani Kerim na mëson kushtet e besimit

Kurani Kerim, para çdo gjëje njeriun e fton që të besojë. Na mëson se ç’duhet dhe kujt duhet ti besojmë në këtë rruzull. Nga kushtet dhe kriteret e para të Kuranit, na fton të besojmë Njeshmërinë dhe Ekzistencën e Allahut. Pastaj vijjnë me radhë: besimi në melaike, librat që ka shpallur, në pejgamberët dhe kaderin se gjithçka ndodh, ndodh me caktimin e Allahut. Këto janë të lidhura me besimin në Allahun. Ne I besojmë Atij me gjithë zemër, ashtu sikur na ka treguar.

Kurani i thërret njerëzit në Islam. Shpjegon se çfarë do të përfitojnë ata që besojnë. Kurse për ata që nuk besojnë, tregon se do të përballen me përfundim të keq dhe na jep shembuj lidhur me këta se ç’u ka ndodhur në të kaluarën.

Në Kuran më së shumi rendësi i jepet besimit të Allahut/ Tevhid. Tevhidi, është besimi tek Allahu dhe pranimi se Ai është Një dhe i Vetëm. Të njihet Allahu, vetëm Atij t’I bëhet ibadet dhe të mos pranohet zot askush tjetër përveç Tij. Ata që pranojnë parimin e Njeshmërisë së Allahut/ Tevhid, asnjëherë nuk kërkojnë ndihmë nga putat dhe nuk i adhurojnë ata. Zaten, adhurimi i një cope guri pa shpirt ose kërkimi i ndihmës prej tyre, nuk i ka hije një njeriu të mençur. Këto gjëra i bëjnë vetëm injorantët dhe të paditurit. Nëse njeriu E njeh me të vërtetë Allahun, i kupton shumë më mirë kërkesat e tij.

Meqë Kuran i jep shumë rendësi Tevhidit, Tevhidit mund t’i themi zemra e Kuranit. Nëse një person vepron gjëra që do të zhvleftësonin Njeshmërinë dhe Ekzistimin e Allahut xh.sh., besimi i tij është në një kurth të madh. Ashtu sikur një njeri vdes kur t’i pushojë zemra, edhe dobësimi i besimit me kalimin e kohës bën që ai të humbasë krejtësisht.

Pasi të besojmë, duhet t’i zbatojmë në praktikë sjelljet tona, fjalët tona dhe besimin tonë, të shmangim haramet dhe të këqijat. Kjo mund të dëshmohet duke bërë punë të mira a të

dobishme. Çdo gjë e bukur dhe e mirë që bëjmë, është vepër e shëndoshë.

Personi, i cili jetën e tij e jeton me iman, orientohet tek gjërat e mira e të bukura dhe qëndron larg të këqijave. Ky është një rezultat i besimit të natyrshëm, sepse personi që beson, mundohet të jetojë sipas urdhrave të Kuranit. Natyrisht që tërë kjo personin e bën një mysliman të mirë, i cili do të respektohet nga të gjithë të tjerët dhe të veprojë punë të mira e të largohet nga të këqijat.

Kurani tregon se kjo jetë është kalimtare, se njeriu, pasi të vdesë, do të ringjallet dhe se do të japë llogari në botën tjetër të Ahiretit, për veprat që ka bërë në këtë botë. Lidhur me këto çështje, Kurani na ka tërhequr vërejtjen. Ata që jetojnë sipas Kuranit, ai i përgëzon se ata në Ahiret do të jetojnë përgjithmonë të lumtur. Në këtë mënyrë nga Kurani mësojmë se jeta e kësaj bote është kalimtare dhe se bota e Ahiretit është e përhershme dhe e pasosur. Sigurisht që çdo njeri do të marrë shpërblimin për çdo punë që ka bërë në këtë botë. Për këtë shkak Kurani na e përmend shpesh jetën e Ahiretit, në mënyrë që të mos e harrojmë.

Kurani na mëson ibadetin

Në Kurani na urdhëron t'i bëjmë ibadet Allahut xh.sh. dhe në të gjenden normat kryesore të ibadetit. Mirëpo, ne mësojmë nga Pejgamberi a.s. se si ta mësojmë e ta kuptojmë Kurantin dhe t'i kryejmë ibadetet. Ai, me anë të praktikës dhe sjelljeve të tij, u ka treguar myslimanëve se si t'i bëjnë ibadetet. Përveç kësaj, nga Pejgamberi mësojmë jo vetëm si t'i kryejmë ibadetet, po edhe për të gjitha rregullat e tjera të fesë. Jeta dhe sjelljet e tij janë shembulli më i mirë për ne. Pejgamberi a.s. ka urdhëruar: "Edhe ju faleni namazin në atë mënyrë siç falem unë." Dhe: "Ibadetet e haxhit kryeni siç i kryej edhe unë."

Namazi është ibadet ditor. Ai na mundëson që t'i mbajmë gjithmonë të mira lidhjet me Allahun. Ai në çdo aspekt është



“O ju që besuat, mos shkoni gjurmëve të djallit, sepse kush ndjek gjurmët e djallit, ai urdhëron për të shëmtuara e të irituara, e sikur të mos ishte mirësia e Allahut ndaj jush dhe mëshira e Tij, askush prej jush nuk do të pastrohej kurrë (prej mëkateve), por All-llahu e pastron atë që do Ai. All-llahu dëgjon e di.”

Sure: Nur; ajeti 21



“All-llahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, dhe ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim.”

Sure: Nahl; ajeti 90

një pastërti. Me abdestin që marrim para namazit, e pastrojmë trupin. Namazi e mbron nga të këqijat atë që e fal namazin dhe pesë herë në ditë e kthen fytyrën e tij nga Qabeja e shenjtë.


Një herë në vit, në muajin Ramazan, agjërohet. Edhe nga agjërimi ka shumë dobi morale dhe materiale.

Zekati, i cili është një ibadet që ka të bëjë me pasurinë, është i detyrueshëm për të pasurit. Çdo vit myslimanët e pasur ua japin të varfërve një pjesë nga pasuria e tyre. Kjo i ndihmon personit që të fitojë ndjenjën e bashkëjetesës dhe përforcon lidhjet e tij me të tjerët.

Edhe Haxhi është një ibadet, i cili ka të bëjë me myslimanët që kanë mundësi financiare-pasuri. Për ata që kanë mundësi financiare, është detyrim që një herë gjatë jetës ta vizitojnë qytetin ku është rritur Pejgamberi a.s. - Mekën / Qabenë, sipas rregullave që kërkohen. Të gjithë myslimanët e botës I drejtohen Allahut dhe I bëjnë ibadet, pavarësisht që janë të racave të ndryshme dhe flasin gjuhë të ndryshme.

Përveç këtyre ibadeteve, ka edhe disa tjera, si fitrat, kurhani etj.

Ibadete llogariten edhe të gjith punët që i kryejmë me seriozitet, mendimet e mira, sjelljet e mira ose edhe ndihma e atyre që kanë nevojë. Ibadet



është edhe ujitja e një luleje që është tharë. Ibadete njihen edhe ushqimi i një maceje, shërimi i plagës së krahut të një dallëndysheje. Sepse ne nuk presim të na vijë ndonjë e mirë dhe as dobi, nëse i duam të gjitha gjallesat dhe u ndihmojmë atyre. Të gjitha gjallesat i ka krijuar Allahu xh.sh. dhe ne më shumë e duam krijuesin sesa krijesat.

Ibadetet na afrojnë tek Allahu xh.sh.. Njeriu është një krijesë - ekzistencë që përbehet nga një shpirt dhe një trup. Sikurse ka nevojë trupi për ushqim, pije dhe gjumë, edhe shpirti ka disa nevoja. Nevojat e shpirtit i plotësojmë duke bërë ibadet. Me ibadetet që bëjmë, përmbushim Urdhrin e Allahut, po edhe ushqejmë shpirtin tonë. Ibadeti forcon imanin tonë dhe e lartëson shpirtin tonë. Ai në zemrat tona mbjell dashurinë ndaj Allahut.

Kur'ani na mëson se si te bëjmë dua

Në Kuran ka shumë lutje/dua të mira. Allahu na mëson se si t'i bëjmë Atij dua, e në librin tonë ka dua të tilla shumë. Ne me duatë tona E falënderojmë Allahun, i Cili na ka krijuar dhe na jep mirësi të shumta. Kur të kemi ndonjë brenjë a ndonjë vështirësi, hapim duart dhe I lutemi Atij për ndihmë. Allahu na dëgjon ne dhe, nëse duanë e kemi bërë me sinqeritet, Ai na e pranon.

Duaja është thelbi i ibadetit. Ajo krijon lidhje të fuqishme në mes robit dhe Allahut. Duke qenë se Allahu xh.sh. i di shumë mirë fshehtësitë që kemi në zemrat tona, na ndihmon në çastet kur jemi pa rrugëdalje, dhe kur kemi shumë nevojë, Ai e dëgjon zërin tonë, dhe në këtë mënyrë na i largon brenget tona. Ai nuk dëshiron aspak që njerëzit të përballen me probleme.

Ajo që na takon neve, është që ne duhet t'i bëjmë dua Allahut nga brendësia e zemrës sonë. Zoti ynë, i Cili di të hapurën e të fshehtën, shikon në zemrat të njerëzve dhe jo pamjet e jashtme të tyre.



“Zoti ynë! Më fal (gabimet) mua edhe prindërve të mi, fali edhe të gjithë besimtarët ditën kur jepet llogaria.”

Sure: Ibrahim: ajeti 41



*“Ne e urdhëruam
njeriun t’u bëjë
mirë prindërve të
vet.”*

Sure: Ahkaf; ajeti 15

Kurani na mëson të jemi të moralshëm

Kurani na tregon rregullat e moralit të mirë dhe nga ne kërkon që t’u përmbahemi atyre. Lumturia e njerëzve është e lidhur me zbatimin e atyre rregullave. Njeriun e bëjnë të lumtur në këtë botë dhe botën tjetër: sjellja e mirë ndaj nënës dhe babait, të afërmeve, skamnorëve dhe atyre që kanë mbetur në rrugë... Gjithashtu nga ne kërkohet që të mos bëjmë harxhime të panevojshme, të realizojmë premtime, sigurinë, të qëndrojmë larg nga të këqijat, të mos e plaçkitim pasurinë e jetimëve, të mos e dëmtojmë askënd dhe as mallin e ndokujt. Po ashtu nga rregullat e moralit të mirë që kërkohen nga ne janë: të kemi harmoni me njërin – tjetrin, të jemi vëllëzër, të ushtrojmë drejtësi dhe barazi, të kemi parasysh të drejtat e të tjerëve, të ndihmohemi, të bashkëpunojmë, t’i bëjmë punët sa më mirë, të punojmë dhe të jemi dorëdhënës. Ne duhet të ruhem nga shkelja e ligjeve të Allahut, dhe nga kushtet e tjera kryesore të Kuranit. Gjithnjë duhet të bëjmë të mira, t’i mbajmë premtimet dhe të jemi të ndershëm e të kemi turp.

Një nga normat që Kurani dëshiron që më së shumti t’i kushtohet kujdes, është drejtësia. Drejtësia është të sigurojë e të ruajë liritë e të gjithëve dhe të mos i cenojë njerëzit a të të drejtat e tyre. Allahu kërkon nga ne që të jemi të drejtë, pa bërë kurrfarë dallimi nga feja, raca apo gjuha. Duke u bazuar në këtë normë, myslimanët gjatë gjithë historisë kanë jetuar në paqe me njerëz të feve dhe racave të ndryshme. Muslimanët, asnjëherë nuk i kanë detyruar jehudinjtë dhe të krishterët, që të ndërronin fenë e tyre, kur ishin nën sundimin e tyre, veçse përkundrazi, ata i kanë lënë të lirë, të jetonin në paqe.

Bukuria e shpirtit vërehet tek bukuria e moralit. Ai që ka moral të mirë, e ka edhe brendësinë/shpirtin të mirë. Njeriu më i mirë është ai që i beson Allahut dhe Pejgamberët, ndjek rrugën e tyre dhe ka moral të mirë.

Kurani Kerim kërkon nga ne që të qëndrojmë larg nga gënjeshtria, mashtrimet, pëlqimi vetëm i vetvetes, shikimi i të tjerëve të nënçmuar apo thënia e fjalëve të fëlliqëta.

Për këtë shkak, Kurani na ka treguar për normat dhe kriteret morale të nevojshme, në mënyrë që njerëzit të jetojnë të lumtur dhe në liri.

Njeriu posedon hapësirë të gjerë përgjegjësie, duke nisur nga vetja e tij e deri tek Krijuesi. Ai, përgjegjësinë e tij dhe detyrën e tij ndaj Allahut e kryen duke i kryer ibadetet, kurse ndaj njerëzve duke u sjellë në mënyrë të moralshme me ta.

Kurani na mëson hallallin, haramin, të mirën, të keqen, të drejtën dhe të gabuarën

Kurani na tregon se ç'na ka lejuar ç'na ka ndaluar Allahu; na mëson se ç'është e mirë e ç'është e keqe; se si të përhapen të mirat dhe të shëndetshmet dhe nga ne kërkon t'u shmangemi të këqijave. Sepse punët hallall dhe të mira, ne na bëjnë të lumtur, kurse të këqijat dhe mëkatet, na i nxijnë zemrat tona.

Kurani u jep shumë rëndësi fitimit hallall dhe punëve të dobishme. Kërkon nga ne të arrijmë fitim hallall, dhe artikujt e ngrënies dhe pirjes, të jenë hallall dhe të pastra. Ai na i ndalon të hamë gjërat e ndaluara, mishin e thiut apo mishin e coftinave. Kërkon nga ne të mos pimë alkool dhe të mos përdorim gjëra trishtuese, si droga. Ai i njeh si mëkate të mëdha veprimet që sjellin fitime pa mund, si: plaçkitjen, kamatën, bursën e zezë, bixhozin, ryshfetin, po edhe marrjen e mallit me dhunë.

Kurani Kerim urdhëron të sillemi mirë me të gjithë njerëzit, ai na urdhëron të mos i bëjmë të padrejtë askujt, të mos kërkojmë të metat dhe gabimet e njerëzve, të mos tallemi me ta, të mos i nënçojmë ata, të mos shpifim për ta dhe të mos u vëmë emra të shëmtuar.

Në Këtë mënyrë ai kërkon nga njeriu që të jetë shembull në rrethin ku jeton, të ketë siguri, pastërti, dashuri dhe respekt të dyanshëm etj..

❁❁❁❁❁

*“Zoti yt ka dhënë
urdhër të prerë që
të mos adhuron
tjetër përveç Tij,
që të silleni në
mënyrë bamirëse
ndaj prindërve.
Nëse njërin prej
tyre, ose që të dy, i
ka kapur pleqëria
nën kujdesit tënd,
atëherë mos u thuaj
atyre as
“of - oh”, as mos u
bëj i vrazhdë ndaj
tyre, po atyre thuaju
fjalë të mira (të
buta, respektuese).”*

Sure: Isra; ajeti 23



Kurani Kerim, nga ne kërkon të jemi në paqe dhe të pajtuar me vetveten tonë, me fqinjët tanë dhe me njëdisin ku jetojmë. Ai na këshillon që të qëndrojmë sa më larg nga gjërat dhe sjelljet që do t’i shqetësonin të tjerët. Kërkon nga ne që të jemi gjithmonë pranë së bukurës dhe së mirës. Urdhëron t’u ndihmojmë atyre që kanë nevojë, duke nisur që nga të afërmit tanë.

Kurani i jep rendësi të madhe jetës familjare

Kurani na e bën të ditur vendin e familjes në bashkësi, ai u tregon të gjithë anëtarëve të familjes detyrat e tyre të për-bashkëta, në mënyrë që ta kalojnë jetën familjare në dashuri e harmoni. Urdhëron që fëmijët të mësojnë dhe të rriten sa më mirë, në mënyrë që të bëhen anëtarë të rëndësishëm në familjen e tyre. Kërkon nga ne që të respektojmë nënën dhe babanë. U jep shumë rendësi lidhjeve familjare. Urdhëron të kujdesemi për jetimët dhe skamnorët.

Kurani na mëson të kemi dashuri ndërmjet nesh


Kurani kërkon nga ne të duam familjen tonë, nënën e babanë, dhe t’i respektojmë ata. Sepse ata na sollën në këtë bëtë. Ne i duam shumë ata. Për këtë shkak, ne kemi respekt ndaj nënës e babait tonë, por edhe ndaj vëllezërve e motrave tona.

Kurani kërkon nga ne të kemi raporte të mira me të afërmit tanë dhe gjithmonë të kalojmë mirë me ta. Ne duhet t’i duam edhe fqinjët tanë, t’i duam, të kemi raporte të mira me ta dhe ,në kohë të vështira, të ndihmohemi ndërmjet nesh. Sepse njerëzit jetojnë me fqinjët afër njëri-tjetrit. Ne mund t’ua zvogëlojmë dhimbjet e tyre, duke i ndarë problemet bashkërisht, po ashtu edhe ua shtojmë lumturinë, duke u gëzuar bashkërisht me ta.








*Ju e kishit
 shembullin më
 të lartë në të
 dërguarin e
 All-llahut, kuptohet,
 ai që shpreson
 në shpërblimin e
 All-llahut në botën
 jetër, ai që atë
 shpresë e shoqëron
 duke e përmendur
 shumë shpesh
 All-llahun.*

Sure: Ahzab; ajeti 21



Kurani Kerim kërkon nga ne që t'i duam të gjithë njerëzit. Pa marrë parasysh se cilit popull a cilës racë i takojnë, ne i duam të gjithë njerëzit.

Sepse Allahu xh. sh. i ka krijuar njerëzit të barabartë. Askush nuk gëzon përparësi ndaj të tjerëve. Përparësia / devotshmëria e vërtetë është - që të mos i kundërshtojmë Urdhrat e Allahut, të fitojmë dashurinë e Tij, të ruhem i ndaj kundërshtimit të Urdhrave të Tij, dhe të jemi sa më afër Tij. Është në duart tona mundësia që ta shndërrojmë këtë botë në një kopsht lulësh duke dashur njëri - tjetrin. Çfarë i sollën njeriut luftërat dhe problemet, përveçse lot të derdhur! Asgjë nuk është më e vlefshme se jeta e njeriut. Shumë mirë thuhet në Librin tonë se të mbrosh jetën e një njeriu, është sikur të kesh ndihmuar të gjithë njerëzit që të jetojnë. Përsëri, në Kuranin tonë shkruan se mbytja e një njeriu është sikurse t'i mbytësh të gjithë njerëzit.

Kurani Kerim kërkon nga ne që t'u shtrijmë dorën e ndihmës skamnorëve ose atyre që janë pa çati mbi krye. Sepse ne jemi njerëz. Detyra jonë njerëzore është që t'u ndihmojmë atyre që nuk kanë askënd, dhe atyre që janë pa rrugëdalje. Ne u ndihmojmë të gjithëve, sepse jemi njerëz.

Kurani Kerim, kërkon nga ne që t'i duam të gjitha krijesat, me shpirt dhe pa shpirt. Ne i duam edhe yjet e qiellit që ndriçojnë natën, Hënë, Diellin, shiun, erën. I duam lumenjtë që rrjedhin, lulet shumëngjyrëshe, fluturat që fluturojnë, zogjtë që cicërojnë nëpër lisa. Atoa na kujtojnë Krijuesin tonë. Gjithashtu ato na kujtojnë se njeriu është krijesa më e çmueshme në sipërfaqen e tokës.

Kurani Kerim kërkon nga ne që ta duam Allahun xh.sh., i Cili na krijoi në formën më të bukur. Sepse çdo gjë në botë është krijuar për ne. Edhe ne E duam shumë Allahun, i Cili na do ne. Ne e duam edhe Kuranin, i cili u mëson njerëzve diturinë dhe dashurinë.

Kurani Kerim kërkon që të duhen edhe fëmijët. Fëmijët

kanë aq shumë nevojë për dashuri, saqë nënat e tyre pikërisht me dashuri i rritin. Edhe me shumë se këta, janë foshnjat që duhen, të cilat sikur janë krijuar vetëm për t'i dashur. Edhe fëmijët kanë nevojë për kujdes dhe dashuri, ashtu sikur uji e dheu e mbajnë të gjallë lulen. Për këtë shkak, Kurani kërkon nga ne që edhe më shumë t'i duam e të kujdesemi për skamnorët dhe jetimët.

Fëmijët lindin pa mëkate dhe të pastër. Kurani, ardhjen e tyre e shpjegon me myzhde. Ata vërtet janë gëzim. Janë myzhde që vijnë nga Allahu xh.sh.

Fëmijët janë dhuratë nga Allahu dhe dritë e syve. Kurani ata i quan dritë e syve. Ata janë dritë e syve për nënat e etërit, gjyshët e gjyshet.

Përsëri sipas Kuranit, ata janë bukuria dhe hijeshia e kësaj bote. Ata posedojnë mirësi të shumta të Allahut.

Pejgamberi a.s. i donte fëmijët shumë dhe u jepte rëndësi të madhe. Kur i dëgjonte tek qanin, e mbaronte sa më shpejt namazin. I merrte në prehër dhe thoshte: “Këta janë aroma e Xhenetit.” Ai nuk mund ta duronte aspak shqetësimin e tyre. Kurse shqetësimin e jetimëve, nuk mund ta e pranonte assesi. Ai i merrte ata në shpinë, qeshte dhe luante me ta. U jepte selam dhe i pyeste për gjendjen. I donte, i puthte, i ledhatonte, i bartte në shpinë dhe luante me ta. Dhembjet e tyre i hetonte dhe i ndiente me gjithë zemër.

Në këtë mënyrë u mësuan edhe të parët tanë, nga Pejgamberi dhe Kuani, se si të sillen me fëmijët.

Këshilla për fëmijë nga Kurani

“E Ibrahim i porositi bijtë e tij me këtë (fe), e edhe Jakubi. (u thanë) “O bijtë e mi, All-llahu jua zgjodhi fenë (islame) juve, pra mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë myslimanë”!

“A ishit ju (ihtarë të librit) dëshmitarë kur Jakubit iu

❁❁❁❁❁
*“E kur fëmijët tuaj
 të arrijnë moshën
 e pjekurisë, le të
 kërkojnë leje (për
 hyrje) ashtu si
 kërkuan ata para
 tyre. All-llahu ju
 shpjegon dispozitat
 e veta, sepse Ai di
 më së miri dhe është
 më i urti.”*

Sure: Nur; ajeti 59



afrua vdekja, e ai bijve të vet u tha: “Çka do të adhuroni pas meje”? Ata thanë: “Do ta adhurojmë Zotin tënd dhe Zotin e prindërve tuaj: Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, të vetmin Zot dhe ne, vetëm Atij i jemi dorëzuar”! (Sure: Bekare; ajetet 132 - 133)

(Kujtoja popullit tënd) Kur Llukmani, duke e këshilluar, i tha të birit: “O djali im, mos i bëj All-llahut shok, sepse idhujtaria është padrejtësia më e madhe!”

Ne njeriun e kemi urdhëruar për (sjellje të mira ndaj) prindit të vet, sepse nëna e vet e barti atë me mund pas mudi dhe pas dy vjetësh ia ndau gjirin. (E porositëm) Të jesh mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj dy prindërve të tu, sepse vetëm tek Unë është kthimi juaj.

E nëse ata të dy tentojnë që ti të më bësh Mua shok, për se ti nuk ke kurrfarë fakti, atëherë mos i respekto ata, po në çështjet e jetës së kësaj bote, të kesh mirëkuptim ndaj tyre, e ti ndiq rrugën e atij që është i kthyer nga Unë, mandej kthimi juaj tek Unë, e Unë do t’ju njoftoj për atë që keni punuar.

O djali im, s’ka dyshim se edhe nëse ajo (vepra) peshon sa kokrra e lirit, e të jetë e fshehur nën rrasë guri, ose në qiej apo në tokë, All-llahu do të ta sjellë atë, se All-llahu është i butë dhe hollësisht i informuar.

O djali im, fale namazin, urdhëro për punë të mira e ndalo nga të këqijat, përballo me durim çdo gjë që të godet, vërtet, këto janë nga çështjet më të preferuara.

Dhe mos shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve, mos ec nëpër tokë kryelartë, se All-llahu nuk e do as mendjemadhinë e as atë që lavdërohet shumë.

Të jesh i matur në ecjen tënde, ule zërin tënd, se zëri më i egër është zëri i gomarit. (Sure: Lukman: ajetet; 13-19)

TË LEXOJMË...

MERIMANGA SHPJEGON SUREN QË KA ZBRITUR NË EMËR TË SAJ.

Unë jam merimangë e vogël. Mos u mrralni menjëherë, sepse e di që shumica prej jush nuk e pëlqeni pamjen time, madje dikush edhe frikësohet. Mirëpo, mos e harroni këtë, se Allahu xh.sh. nuk ka krijuar asgjë pa nevojë dhe kot së koti. Ai në Kuran ka folur për mua dhe me emrin tim i ka zbritur suren e 29 (Ankebut) Muhammedit a.s.. Do t'ju rrëfej shkurtimisht rreth kësaj sureje.

Surja Ankebut ka 69 ajete. Nga çështjet kryesore që përmenden në këtë sure, janë besimi në Allahun, respektimi i prindërve, përfundimi i keq i atyre që bëjnë vepra të këqija dhe shpërblimi i atyre që kanë besuar dhe bëjnë vepra të mira. Përveç kësaj, tregohet edhe për ata që falin namaz, se namazi e largon njeriun nga të këqijat, se kujtimi i Allahut është ibadet i madh dhe se njerëzit kur janë rahat nuk çajjnë kokën që Ta përmendin dhe t'i luten Atij. Kjo sure po ashtu tregon edhe rreth faktit se çdo krijesë një ditë do të vdesë, se gënjeshtria është gjë e shëmtuar dhe se çdokush do të gjykohe vetëm për mëkatën e vet. Në këtë sure flitet më tutje edhe rreth ngjarjeve të pejgamberëve Nuh, Ibrahim, Lut, Shuajb dhe Hud.


Tash të kthehemi tek çështja e sures, që ka të bëjë me ne. Kjo sure emrin e saj e ka marrë nga krahasimi me rrjetën e merimangës, që përmendet në ajetin e 41-të të kësaj sureje. Qëllimi i krahasimit në këtë ajet është shembull që të tregojë besimet dhe vlerat e rrejshme të atyre që janë të dobët dhe pa bazë para së vërtetës. Ankebut d.m.th. merimangë femër. Kur merimanga femër të ndërtojë shtëpinë (rrjetën) e vet, ajo aty e mbyt menjëherë bashkëshortin e saj. Më pas, kur në atë shtëpi të hyjnë mizat ose insekte të tjera, ato bien në kurth. Shtëpia që ngremë ne, sipas nesh, është mjaft e



*“Shembulli i atyre,
të cilët veç All-llahut
morën mbrojtës
(zota idhujsh),
është si shembulli
i merimangës
që thur shtëpi,
e sikur ta dinin
ata, më e dobëta
shtëpi e shtëpia e
merimangës.”*

Sure: Ankebut; ajeti 41





sigurt, saqë fijet e rrjetës së merimangës janë më të forta se telat e çeliktë me të njëjtën trashësi.


Njerëzit nuk e dinë, po dua t'ju tregoj juve. Kur ne merimangat duam ta ndërtojmë shtëpinë tonë, së pari bëjmë llogarinë matematikore dhe gjeometrike. Rrjetat që i thurim, për ne janë edhe shtrat edhe mjet komunikimi, lloj alarmi dhe arma jonë. Edhe nëse rrjeta jonë, sipas nesh është shumë e sigurt, nga të gjithë të tjerët, dihet se ajo konsiderohet shumë e dobët. Shtëpia e merimangës as nuk bën hije dhe as nuk të mbron. Për fat të keq, ajo shkatërrohet nga era ose me të prekur.

Ja pra ndodhitë që shpjegohen në këtë sure apo mesazhet që jepen këtu, - kjo njihet si shembulli i merimangës. Sikurse është e dobët shtëpia e merimangës, është po ashtu i dobët edhe besimi dhe mbështetja e atyre që besojnë në ndihmën e të tjerëve përveç ndihmës së Allahut xh.sh.. Në shumë raste kur njerëzit i pranojnë dhe u japin rrëndësi disa fuqive, ata këto fuqi i pranojnë si fuqi absolute të kësaj bote. Shumë nga njerëzit si fuqi më të rëndësishme e njohin pozitën/postin, pasurinë a paranë. Ata mashtrohen pas këtyre gjërave. Por edhe shumë prej tyre vrapojnë pas diturive të padobishme. Ndonjëherë njerëzit e pranojnë se arma dhe bombat e mëdha atomike janë mbi çdo gjë. Mirëpo, në të vërtetë, ata duhet të shikojnë fuqinë hyjnore, e cila e ka krijuar këto.

Në këtë mënyrë Allahu i krahason të gjitha këto me shembjen dhe dobësinë e rrjetës së merimangës, e cila me një të prekur apo nga fryma, - shkatërrohet. Fuqia dhe forca e vërtetë është miqësia e Tij. Gjërat e tjera, jashtë kësaj Force, sadoqë të duken të fuqishme, ato tek Allahu kanë vlerën dhe fuqinë e merimangës. A nuk e dinë ata që Allahu e shkatërroi me insekte Nemrudin, i cili e konsideronte veten zot dhe apo ata të cilët me plot armë kishin ardhur deri para shpellës për ta mbytur Pejgamberin a.s. që ishte i fshehur aty e që Allahu ata i mashtroi me merimangë? Ata e dinë këtë, por nuk dëshirojnë ta pranojnë të vërtetën.

Dua që, së bashku me ju, të rrëfej edhe për një çështje tjetër, meqë jemi në këtë temë. Në të njëjtën kohë, unë jam merimangë, që kam pasur detyrë të rëndësishme gjatë udhëtimit – hixhretit të Pejgamberit Muhamed a.s. nga Meka në Medinë. Allahu i Madhëruar; mua më detyroi që në derë të shpellës të thurra rrjetën, në mënyrë që të mbroja Muhamedin a.s. dhe shokun e tij të rrugës, hazreti Ebu Bekrin. Lumturia më e madhe imja ka qenë që unë e kam parë fytyrën e ndritshme të Muhemedit a.s. gjatë tri ditëve që kam kaluar me të dhe me shokun e tij të rrugës, që ishin ditët më të mira të jetës sime. Çfarë lumturie e madhe për mua!

Po qe se i besoni edhe ju dhe mbështeteni në Allahun, do të përballoni me lehtësi të gjitha vështirësitë që do t'u dalin në jetë. Mbështetuni në Allahun, sepse nuk ka ndihmës më të madh dhe më të vërtetë se Ai.



PJESA E KATËRT

MËSIMET QË DUHET T'I MARRIM NGA TREGIMET

Njeriu i parë ishte edhe peygamberi i parë

Allahu së pari krijoi babanë tonë, Ademin a.s., pastaj nënën tonë, Havanë. Më pastaj që të dy i bëri bashkëshortë. Atyre ua mësoi të gjitha ekzistencat dhe emrat e tyre. Ademit ia mësoi të thoshte Hava, kurse Havasë ia mësoi të thoshte Adem. Ata i mësoi të njihnin dhe të dinin gjithçka. Ademin e bëri peygamber. I gjithë njerëzimi u shumëzua nga fëmijët e Ademit dhe Havasë. Ata u shpërndanë në vende të ndryshme të tokës. Pastaj në sipërfaqen e tokës u shfaqën gjuhë dhe popuj të ndryshëm. Raca e bardhë dhe e zezë u shumuan nga Ademi dhe Havaja. Edhe të verdhët dhe të tjerët - nga fëmijët e tyre. Ne, edhe nëse i kemi flokët me ngjyrë të ndryshme, edhe nëse flasim gjuhë të ndryshme, edhe nëse ngjyra e syve tanë është e ndryshme, megjithëkëtë të gjithë kemi një zemër, dy duar dhe dy këmbë. Dhe pos të gjithave kemi një mendje. Të gjitha këto na i mëson Kurani. Po të mos na tregonte ai për këto, ne nuk mund të dinim se si janë kriju-

ar njerëzit, si janë shumëzuar ata dhe pse janë shpërndarë në sipërfaqen e tokës. Ne i dimë këto, meqë në Kuran shkruan se sipërfaqja e tokës është në shërbim të njerëzve.

Para Ademit a.s. janë krijuar melaiket dhe xhindet. Kur Allahu u tha melaikëve se në sipërfaqen e tokës do të krijonte njeriun, ato thanë: Ne të adhurojmë Ty, Të madhërojmë. Ne po frikësohemi se njeriu që do të krijosh në sipërfaqen e tokës, do të bëjë çrregullime dhe do të derdhë gjak. Pastaj Allahu atyre u tha: “Ju nuk dini ato që di Unë”. Dhe në këtë mënyrë Ai krijoi njeriun dhe Pejgamberin e parë, Ademin. Pastaj atij i dha shpirtin.

Allahu Ademit a.s. ia mësoi emrin e çdo gjëje. E mësoi që ti thotë diellit diell, tokës tok, erës erë, lules lule, zogut zog. Ademi a.s. i mësoi të gjithë emrat e krijesave që ishin. Mirëpo Allahu këto nuk ua pat mësuar melaikëve. Ai e përsosi Ademin a.s. dhe njerëzit tjerë në krahasim me krijesat tjera. Pastaj Allahu kërkoi nga Ademi a.s. që tu tregojë melaikëve emrat e krijesave. Kur Ademi a.s. i tha të gjithë emrat, melaiket me urdhrin e Allahut e pranuan epërsinë e tij dhe i bënë sexhde. Por vetëm shejtani nuk e dëgjoi urdhrin e Allahut dhe nuk e pranoi epërsinë e Ademit a.s.. Ai e nënçmoi Ademin se është i krijuar nga dheu, kurse vet ai nga zjarri. Me këtë mburrje ai e kundërshtoi edhe Allahun. Por edhe zjarrin e edhe dheun e kishte krijuar Allahu dhe ka do të kishte epërsi zjarri nga dheu! Ademi a.s. ishte më i përsosur nga krijesat tjera jo pse ishte krijuar nga dheu, por se i ishte dhënë liri dhe mendje.

Allahu i Madhëruar e mallkoi shejtanin deri në kijamet i cili e kundërshtoi Atë, u mburr dhe e nënçmoi njeriun. Atij i dha kohë deri kur njerëzit të gjithë të vdesin dhe të ringjallen. Shejtani në vend se të pendohej dhe të kërkoj falje për gabimin e bërë, ai u bë mendje madh dhe u mburr, dhe në këtë mënyrë ai vazhdoi ta e kundërshtoi Allahun. Tha se do të bënte gjithçka

që njerëzit t'i largoj nga të mirat dhe gjërat e vlefshme. Kështu pra, shejtani u bë armiku i të gjithë të mirave.


Pasi krijoi Ademin a.s. Allahu krijoi Havanë. Atë e bëri bashkëshorte për Ademin a.s. dhe pastaj ata i vendosi në Xhenet. Atyre ua ndaloi të hanin fruta të një peme. Ai u tregoi se shejtani është armiku më i madh i njerëzve dhe i këshilloi që të qëndronin larg tij.


Megjithëkëtë, shejtani i mashtroi ata duke u thënë se, nëse do të hanin nga ajo pemë, ata do të bëheshin të pavdekshëm, dhe ia arriti qëllimit që t'i bindte. Por Ademi a.s. dhe Havaja e kuptuan se kishin bërë gabim dhe u penduan. Menduan dhe filluan të shqetësoheshin se do të shkonin në Xhehenem, ashtu sikur shejtani, përgjithmonë. Allahu e kuptoi se ata u penduan dhe se ishin shumë të pikëlluar për veprimin e tyre. Ai ua pranoi pendimin dhe i nxori nga Xheneti dhe i vuri në tokë. Në këtë mënyrë filloi jeta e njeriut në botë.

Ademi dhe Havaja kërkuan nga Allahu që t'u dhuronte fëmijë. Edhe Allahu u fali shumë bij e bija. Në këtë mënyrë filloi të shtohet njerëzimi. Ademi a.s. ishte Pejgamberi i fëmijëve të vet. Allahu e ruajti atë nga mashtrimet e shejtanit.

Dy nga fëmijët e Ademit a.s., Habili dhe Kabili, kishin thekur nga një kurban për Allahun. Kurban i Habilit ishte pranuar, kurse i Kabilit jo. Shejtani, në zemrën e Kabilit futi zili dhe armiqësi. Në fund, Kabili e mbyti të vëllanë. Për herë të parë u derdh gjak në tokë. Shejtani u gëzua për këtë vrasje. Kabili nuk dinte ç'të bënte me trupin e të vëllait. Duke pritur ashtu i hutuar, pa një laraskë. Laraska gërmonte dheun me këmbë për ta mbuluar një laraskë që kishte ngordhur.

Edhe Kabili nisi të mendonte që ai duhej të vepronte ashtu. E gërmoi dheun dhe e futi të vëllanë e e mbuloi. Që nga ajo ditë, njerëzit që vdisnin, varroseshin në dhe.





Më në fund, pasi qe plakur shumë, Ademi a.s. vdiq. Edhe atë e varrosën në dhe.

Ademi a.s. ka qenë njeriu i parë i krijuar, ai është babai i të gjithë njerëzve. Rrobën e parë e kishte veshur ai. Për herë të parë ai e kishte lëvruar dhe mbjellë tokën. Gjërat që dinte vetë, ua mësoi edhe fëmijëve. Ata i këshilloi që të bënin mirësi, të bëheshin njerëz të mirë dhe të jepnin selam.

Për Ademin a.s., Pejgamberi ynë i parë, dhe për jetën e tij, më së miri shpjegon Kurani Kerim.

Anija e Nuhut

Kishin kaluar shumë vjet. Pas Ademit a.s. njerëzimi ishte shumëzuar dhe shpërndarë nëpër tokë. Njerëzit kishin filluar të jetonin në bashkësi. Me kalimin e kohës, ata kishin filluar të largoheshin nga rruga e pejgamberëve dhe të adhuronin putat. Putat që i bënin me duart e veta, ata i konsideronin zota dhe i adhuronin. Kishin harruar se ishin fëmijët e Ademit a.s.. Të dobëtit dhe të varfrit keqtrajtoheshin nga të pasurit dhe të fuqishmit. Zemrat e tyre ishin ngurtësuar, kishin harruar të veprojnë me mëshirë dhe me mirësi. Allahu nga mesi i këtij populli, për ta zgjodhi pejgamber Nuhun a.s.. Hazreti Nuhu ishte njeriu që nuk i bënte askujt të padrejtë, dhe që i besonin dhe e donin të gjithë. Aq sa kishte mundësi, ai u ndihmonte atyre që kishin nevojë, dhe gjithmonë e fliste të vërtetën.

Pasi u bë pejgamber, Nuhu filloi ta thërriste popullin për të besuar Allahun dhe vetëm Atij t'I bënin ibadet. Atyre u tha se ishte i dërguar nga Allahu dhe, nëse ata do të vazhdonin me punë të këqija, të cilat Allahu nuk i do, nuk do të jetonin kurrë të lumtur dhe në liri.

Meqë nuk i besuan thirrjes së Nuhut a.s., ata filluan të talleshin me të dhe me ata që i kishin besuar atij. I thanë: “Edhe ti je

njeri sikurse ne, pse të të besojmë ty?” Megjithëse ishte munduar shumë, pak nga njerëzit i kishin besuar Allahut. Të tjerët vazhdonin t’i adhuronin putat, të bënë vepra të këqija dhe t’i shkelmonin të dobëtit. Ata që nuk besonin, e fajësuan Nuhun a.s. se ishte budalla. Përsa mundën u munduan ta pengojnë thirrjen e tij të mirë. Torturat që i bën Nuhut a.s. dhe besimtarëve, i shtuan aq shumë, saqë i kërcënuan se do t’i mbytnin. Mirëpo, ai vazhdoi ta këshillonte me durim popullin e vet.

Prijësve të atij vendi nuk iu zbutën zemrat e forta dhe ata vazhduan të mohonin me inat. Nuhu a.s. ngriti duart dhe I bëri dua Allahut: “O Allah, ata nuk më besojnë mua, Të lutem më ndihmo”! Pastaj ata që nuk besonin, i thanë se, nëse ai ishte peygamber, le t’i thoshte Allahut që t’i dënonte. Torturat që u bënë Nuhut a.s. dhe besimtarëve, ishin të padurueshme. Për këtë shkak, Nuhu a.s. bëri këtë dua: “O Allah, më shpëto mua dhe ata që besuan.” Allahu i tha Nuhut që të ndërtonte një anije. Askush nuk dinte të ndërtonte anije, sepse deri atë ditë nuk kishte pasur anije. Allahu i Madhëruar e mësoi Nuhun a.s. se si ta ndërtonte anijen. Ai ndërtoi një anije të madhe nga lisat e malit. Pastaj Allahu kërkoi nga Nuhu që ai dhe ata që kishin besuar, të hynin në anije. E porositi gjithashtu që të merrte nga një çift edhe nga të gjitha kafshët. Pabesimtarët nuk mund ta kuptonin fatkeqësinë e madhe që do t’i godiste. Të nesërmen qielli u mbush me mjegull, vranësira dhe e mbuluan vetëtima. Pastaj filloi të derdhej shi nga qielli. Binte shi pandërprerë. Pabesimtarët filluan të vraponin drejt kodrave. Mirëpo, kjo nuk u ndihmoi të shpëtonin.

Shi binte aq shumë, saqë nuk mbeti asnjë pëllëmbë në tokë pa e marrë ujët. Ata që talleshin me anijen e Nuhut a.s., që të gjithë u fundosën dhe vdiqën.

Shiu që kishte rënë për ditë të tëra, kishte pushuar dhe ishin shpërndarë retë nëpër qiell. Përsëri dielli filloi të derdhte rre-

zet e tij mbi tokë, të cilat kishin munguar për një kohë të gjatë. Allahu xh. sh. kishte shpëtuar një grusht njerëzish, të cilët I besuan Atij.

Dalëngadalë uji filloi të tërhiqej. Bjeshkët dhe fushat filluan të shfaqeshin përsëri. Në sipërfaqen e tokës filloi një jetë krejtësisht e re. Për këtë shkak, Nuhu a.s., ashtu sikurse edhe Ademi a.s., llogaritet babai dytë i njerëzimit.

Edhe Nuhu a.s. është peygamberi ynë. Ai e ndërtoi anijen e parë dhe jeta e tij më së miri tregohet në Kurani Kerim.

Kopshti me lule në zjarr

Pas Nuhut a.s. njerëzit u shumëzuan përsëri në sipërfaqen e tokës. Filluan të jetonin në bashkësi duke ndërtuar katunde dhe qytete të reja. Me kalimin e kohës, njerëzit filluan të largoheshin sërish nga mësimet që kishin marrë nga peygamberët, filluan të vepronin gjëra të këqija dhe, në vend të Allahut, filluan të adhuronin zota të tjerë. Për t'u kujtuar njerëzve fenë e Tij, Allahu i Madhëruar u dërgoi shumë peygamberë. Një prej tyre ishte edhe Ibrahim i a.s.. Ai u dërgua peygamber tek populli Babil në Anadollinë e sotme. Njerëzit që jetonin aty, adhuronin Diellin, Hënë, yjet dhe putat, të cilët i ndërtonin me duart e veta.

Para se të bëhej peygamber, Ibrahim i a.s. një natë po shikonte yjet në qiell dhe po mendonte: “Si është e mundur që njerëzit t’i adhurojnë ato për zot?” Yjet që ndriçonin gjatë natës, dhe Hëna, e cila i bënte atij dritë, kur vinte dita, humbnin. Ai tha: “Hëna dhe yjet që herë shfaqen dhe herë zhduken, nuk mund të jenë zoti im.”

Ibrahim i a.s. meditonte vazhdimisht. Një ditë u zgjua para mëngjesit dhe po ndiqte me vëmendje lindjen e diellit. Dielli shndriste. Ai vazhdoi ta vëzhgonte Diellin tërë ditën. Mirëpo

edhe Dielli, në mbrëmje, filloi të zhdukej ngadalë. Ibrahim i a.s. mendoi se as Dielli nuk mund të ishte zoti i njerëzve. Ai kishte vështirësi t'i kuptonte njerëzit. Duhej të ishte një krijues, i cili të kishte krijuar gjithçka: njerëzit, Diellin, yjet dhe Hënën. Ai për ditë të tëra mendoi për këto dhe në fund i besoi Allahu i cili është krijuesi i gjithësisë.

Pejgamberi Ibrahim a.s. kishte moral të mirë, ishte dashamirës dhe bujar. Ai kishte shumë dëshirë që t'i respektonte mysafirët dhe t'u përgatiste gosti, po edhe të ndihmonte skamnorët. Ai, sikurse edhe pejgamberët që kishin qenë para tij, i bëri thirrje popullit që të bënin vepra të mira dhe të largoheshin nga të këqijat.

Edhe babai i Ibrahimit a.s. i adhuronte putat. Çështja e besimit të babait të tij e brengoste shumë. Një ditë i tha t'et: "O baba, përse i adhuron këta puta, të cilët nuk dëgjojnë, nuk shohin dhe as që të bëjnë ndonjë dobi. Bab, Allahu është Një që nuk ka diçka të ngjashëm me Të." Babai i tij u zemërua për këto fjalë të të birit dhe u soll shumë ashpër ndaj tij, dhe i tha: "Si është e mundur që ti të mohosh zotat tanë?" Pastaj e përzuri nga shtëpia. Ibrahim i a.s., edhe pse u nënçmua nga babai i tij, përsëri i bëri dua Allahut xh. sh. që ta falte atë dhe ta udhëzonte në rrugë të drejtë.

Ibrahimi a.s., popullit të tij pa i bezdisur fare, ia bëri me dije që vetëm të adhuronin Allahun dhe përveç Tij, të mos i nënshtroheshin askujt.

Mbreti i Babilonisë, Nemrudi, ishte një person i pashpirt. Populli, për shkak të frikës prej ti, qëndronin larg thirrjes së Ibrahimit a.s.. Një ditë Ibrahim i a.s. shkoi tek ai dhe e ftoi që ta besonte Allahun. Nemrudi, me mburrje, i tha: "Unë jam zoti i këtij vendi. E zoti yt kush është?"

Ibrahimi a.s. iu përgjigj: "Zoti im është Allahu xh.sh. Ai që

të bënë të vdesësh dhe të ringjall.” Pastaj Nemrudi i thirri dy veta të dënuar me vdekje. Njërin nga ushtarët e urdhëroi që ta mbyste njërin, e tjetrin ta linte të lirë. Ushtari veproi siç u urdhërua. Pastaj Nemrudi u kthye nga Ibrahim i a.s. dhe i tha: “A e pe? Edhe unë mbys dhe ngall.” Pastaj Ibrahim i a.s. tha: “Zoti im e lind diellin nga lindja. Nëse ti ke forcë, atëherë bëje që të lindë nga perëndimi.” Pas këtyre fjalëve, Nemrudi nuk pati ç’të thoshte. Po përsëri nuk i besoi Allahut.

Në qytetin Babil ishte një vend adhurimi, ku gjendeshin putat. Populli vinte tek ata dhe jepnin dhurata e pastaj prej atyre kërkonin që t’ua plotësonin dëshirat. Një ditë, kur të gjithë ishin duke u bredhur në panair, Ibrahim i a.s. hyri fshehtas në vendin ku ishin putat. Me sëpatën që kishte në dorë, i theu të gjithë putat përveç të madhit. Pastaj i vuri në qafë sëpatën putit të madh dhe u largua prej andej pa e vënë re askush. Kur përfundoi ceremonia e tyre, populli i Babilit hynë në vendin e putave dhe, kur e panë se ç’kishte ndodhur, qenkëshin habitur të gjithë. Filluan të mendonin se kush mund ta kishte bërë atë. Ata e dinin se Ibrahim i a.s. nuk u besonte putave dhe filluan të dyshonin tek ai. E thirrën menjëherë aty dhe e pyetën “A i ke thyer ti putat?” Ibrahim i a.s. u tha: “Mos ndoshta i ka thyer ky që e paska sëpatën në qafë? Ta pyesim atë, ndoshta ai e di se kush do ta ketë bërë këtë vepër.” Të pranishmit u habitën nga kjo përgjigje dhe filluan të shikonin herë Ibrahimin, e herë putat. Njëri prej tyre tha: “Ibrahim, mos u tall me ne. Edhe ti e di se këta janë pa shpirt. As nuk shohin dhe as nuk flasin. Ku mund ta dijë ai (i madhi)?” Pastaj Ibrahim i a.s., të pranishmëve u tha: “Mirë, bre, po përse i adhuroni këta puta që as shohin dhe as flasin dhe as nuk kanë mundësi të mbrojnë veten e tyre? Atëherë, besoni Allahun, Zotin e botëve.”

Kjo thënie e Ibrahimit i a.s. ndikoi thellësisht tek të pranishmit. Kjo ngjarje nisi të shpërndahej e të arrinte në veshët e


tërë popullit. Disa prej tyre braktisën putat dhe besuan. Kur Nemrudi u informua rreth kësaj ngjarjeje, u zemërua shumë. Ai e kishte kuptuar se nuk do të mund të shpëtonte nga kjo pa e vrarë Ibrahimin. Për t'i frikësuar ata që i kishin besuar, ai vendosi që Ibrahimin ta hidhte në zjarr. Drutë që kishin mbledhur grumbull në qendër të qytetit, ishin bërë sa një bjes-hkë. Pejgamberi Ibrahim e dinte që Allahu do ta shpëtonte. E Nemrudi u kthye nga Ibrahimin që të shihte mos ndoshta do të frikësohej dhe do të braktiste besimin e tij. Mirëpo, ai, pa u frikësuar fare, po qëndronte i qetë. Populli ishte mbledhur pranë zjarrit. Më pas e hodhën Ibrahimin në mes të zjarrit që digjej flakë. Të gjithë shikonin se ç'po ndodhte. Për një çast, zjarri u shndërrua në një kopsht me lule. Kur atyre që kishin besuar më parë, u shndritën sytë dhe zemrat, Nemrudi dhe të tjerët që nuk kishin besuar, u habitën aq shumë, saqë e këputën edhe gjuhën e gojës. Allahu xh.sh. e urdhëroi zjarrin që të mos e digjte Ibrahimin a.s.. Zjarri që djeg çdo gjë, për Ibrahimin ishte shndërruar në një kopsht lulesh të freskëta. Pas kësaj mrekullie që bëri Allahu, Ibrahimin a.s. E falënderoi Allahun nga thellësia e zemrës.


Pas kësaj mrekullie, ata që nuk besuan, nuk patën mundësi që herë të tjera t'i bënin ndonjë të keqe Ibrahimit a.s..

Ibrahimin a.s. u largua nga vendlindja dhe shkoi në Egjipt, për t'i thirrur njerëzit në rrugën e Allahut. Atij i lindën dy fëmijë: Ismaili dhe Is'haku. Allahu xh.sh., edhe Ismailin, edhe Ishakun - i bëri pejgamberë.

Qabenë, të cilën për herë të parë e kishte ndërtuar Ademi a.s., Ibrahimin së bashku me të birin, Ismailin, e rindërtuan.

Edhe Ibrahimin a.s. e edhe Ismailin a.s. - po ashtu janë pejgamberët tanë. Jetën e tyre më së miri e shpjegon Kurani Kerim.





I bukuri i të bukurve, Jusufi a.s.

Pejgamberi Jakub a.s. ishte nipi i Ibrahimit a.s. dhe ishte pejgamber i dërguar në vendin e quajtur Kenan. Jakubi a.s. kishte 12 fëmijë. Jusufi ishte biri i 11, kurse Benjamini ishte fëmija më i vogël.

Jusufi ishte një fëmijë shumë i bukur. Ndër njerëz, kish-te fare pak të bukur sikurse ishte ai. Fëmijë shumë i bukur siç ishte, ai arriti të krijonte harmoni edhe me njerëzit e tjerë. Babai i tij, Jakubi a.s., atij i kushtonte më shumë kohë sesa djemve të tjerë. Ky qe shkaku pse vëllezërit e tjerë e kishin marrë zili.

Një natë Jusufi kishte parë një ëndërr të çuditshme. Në ëndërr atij, njëmbëdhjetë yje, Dielli dhe Hëna po i bënin sexhde. Ëndrën që kishte parë, ia kishte rrëfyer babait të tij. Kjo ëndërr tek babai i tij, Jakubi, kishte ndikuar shumë dhe nga sytë i patën rrjedhë lot. E përqafoi shumë të birin. E kuptoi se Jusufi në të ardhmen do të bëhej pejgamber. Babai i tij e këshilloi që ëndrën të mos ua tregonte vëllezërve të vet. Sepse frikësohej se mos ata po i bënin ndonjë të keqe Jusufit. Për këtë shkak, atë nuk e largonte nga vetja e tij dhe askujt nuk ia linte në dorë, amanet.

Pas një kohe, vëllezërit e tij morën vesh për ëndrën e Jusufit. Kjo edhe më shumë ua shtoi zilinë ndaj tij. Më në fund, ata u këshilluan në mes tyre dhe vendosën ta hiqnin qafe Jusufin. Bënë një plan të fshehtë. Nga babai kërkuan që të gjithë të shkonin në shëtitje diku në mal. Jakubi a.s. nuk lejoi që edhe Jusufi të shkonte me ta. Mirëpo djemtë e tij i thanë: “O baba, ne jemi shumë veta, a nuk do të kemi mundësi ta ruajmë Jusufin? Të lutemi, na lejo që të shkojmë të gjithë së bashku”. Kur i thanë kështu, babai i tyre u dha leje. Të gjithë vëllezërit së bashku morën rrugën. Ishin larguar shumë nga shtëpia e tyre. Atje nuk kishte njeri tjetër. Tanimë do të kishin mundësi ta hiqnin

qafe Jusufin. Pa pikë dhimbjeje për të, vëllezërit e tij e hodhën Jusufin në një pus. Mirëpo Jusufi u mbajt dhe zuri vend pranë shkëmbi aty brenda në pus, dhe në këtë mënyrë nuk u zhyt në ujë. Vëllezërit e tij mendonin se si do ta gënjenin babanë. Më në fund, ata këmishën e Jusufit e bënë me gjak të një shtaze që patën mbytur aty. Të gjithë duke qarë, shkuan në shtëpi me këmishën e Jusufit plot gjak në dorë. Babait i thanë: “Baba, kur ne po luanim aty, ujku e kishte sulmuar Jusufin pa e vërejtur ne. U munduam shumë, por nuk arritëm ta shpëtonim. Vetëm arritëm t’i merrnim këmishën e tij me gjak”. Kur Jakubi a.s. e pa se këmisha e tij nuk ishte askund e shqyer, e kuptoi se ata do t’i kishin bërë ndonjë kurth. Kërkoi prej tyre që të largoheshin menjëherë. Sytë iu mbushën lot dhe në thellësinë e zemrës ndjeu dhembje për Jusufin.

Gjatë kohës kur Jusufi ndodhej pa asnjë rrugëdalje në pus, një karvan që shkonte për në Egjipt, e vunë re dhe e shpëtuan atë. Kur arritën në Egjipt, ata Jusufin e dërguan në shtëpinë e ministrit si shërbyes.

Jusufi ishte rritur dhe ishte bërë një djalosh edhe më i bukur. Gruaja e ministrit ishte habitur nga bukuria e tij dhe kishte rënë në dashuri me të. Në një kohë kur nuk ishte askush në shtëpi, ajo i propozoi Jusufit të bënte gjëra të pamoralshme. Jusufi nuk e pranoi propozimin e saj të pamoralshëm, Sepse ai kishte moral të pastër. Meqë nuk e arriti qëllimin, gruaja e ministrit iu ankua bashkëshortit të saj gjoja për sjellje të pamoralshme të Jusufit, dhe ai e burgosi atë pa të drejtë.

Jusufi kishte qëndruar burg për shumë vjet. Allahu e mësoi atë se si t’i komentonte ëndrrat. Ai i komentonte ëndrrat e shokëve në burg. Ëndrrat dilnin të vërteta, ashtu sikur i komentonte ai. Pastaj Allahu e obligoi atë që si peygamber t’u bënte thirrje njerëzve për të drejtën dhe të bukurën.

Një natë ministri i Egjiptit kishte parë në ëndërr shtatë lopë të majme dhe shtatë lopë të ligshata që po i hanin ato (të ligshatat

i gëlltitën ato të majmet), dhe shtatë kallinj të njomë (që kishin lidhur fryt) e (shtatë) të tjerë të tharë. Këtë ëndërr askush nuk mundi t'ia komentonte. Dikush që ishte njohur në burg me Jusufin a.s. i kishte treguar ministrit se ai i komentuakësh ëndrrat shumë mirë. Për t'ia komentuar ëndrrën ministrit, e nxorën menjëherë nga burgu. Pejgamberi Jusuf i shpjegoi se në të ardhmen do të ketë thatësira të mëdha dhe se ata duhej të merrnin masa për këtë. Ministri, pasi mësoi se shtetin e tij po e prisnin ditë të vështira, Jusufin a.s. e bëri përgjegjës të depos shtetërore.

Jusufi a.s. depozitoi një pjesë të drithit që mbledhën për shtatë vitet e bereqetshme nëpër depo. Pas shtatë vjetësh filluan thatësitat. Në Egjipt filluan të vinin nga vendet fqinje njerëz grupe- grupe për të marrë drithë. Edhe vëllezërit e Jusufit a.s. e lanë Benjaminin tek babai i tyre dhe erdhën në Egjipt për të marrë drithë. Vëllezërit e Jusufit nuk e njohën Jusufin, por ai i njohu ata. Kërkoi prej tyre që, kur të vinin herën tjetër, ta merrnin me vete vëllanë e tyre të vogël, se përndryshe nuk do t'u jepte drithë. Edhe paratë që paguan, ua ktheu atyre. Kur erdhën herën tjetër në Egjipt, vëllezërit e Jusufit kishin marrë me vete edhe Benjaminin. Jusufi a.s. i tregoi Benjaminit për gjithë ç' i kishin ndodhur, e pastaj e përqafoi. Ai bëri plan për ta mbajtur Benjaminin në Egjipt. Kur vëllezërit e tij po ndaheshin, ai në thesin e Benjaminit kishte futur fshehtas gjëra të çmueshme të ministrit. Kur u larguan nga Egjipti, ai e urdhëroi një rojtar që t'ia kontrollonte ata. Në thesin e Benjaminit u gjetën gjërat e humbura të ministrit dhe për këtë shkak arrestuan Benjaminin. Përpjekjet e vëllezërve të tij nuk ndihmuan për ta shpëtuar Benjaminin. Ata u nisën prej andej shumë të pikëlluar. Për këtë ndodhi i treguan babait. Sikur Jakubit a.s. nuk i mjaftonte dhembja për Jusufin që e kishte humbur, dhe tash humbi edhe Benjaminin! Ai zuri të qante dhe nga vaji e lotët, iu verbëruan sytë.

Po megjithëkëtë, ai nuk e humbi shpresën dhe tha: “Mua më takon të jem i durueshëm. Një ditë sigurisht se Allahu do të m’i kthejë djemtë. Ai që di çdo gjë.”

Pas një kohe vëllezërit e Benjaminin shkuan për ta marrë atë. Shkuan tek Jusufi dhe kërkuan prej tij që ta falte Benjaminin. Kur Jusufi i pyeti ata: “Çfarë i keni bërë ju vëllait tuaj”?, ata mbetën të habitur dhe i thanë: “A mos ndoshta, ti je Jusufi”? Filluan të frikësoheshin. Mirëpo Jusufi i fali vëllezërit. Pastaj Jusufi u tha atyre: “Merreni këmishën time dhe dërgojani babait, sepse ai nga era e saj do të më njohë mua”, dhe i përcolli. Jakubi a.s. hetoi erën e Jusufit dhe filloi t’i merrte erë këmishës. Me të fërkoji fytyrën dhe sytë. Në atë çast erdhi ndihma e Allahut për durimin që kishte bërë, dhe Jakubit a.s. po shihte përsëri. Pastaj të gjithë së bashku shkuan në Egjipt dhe Jusufi iu drejtua babait duke i thënë: “O babai im, kjo është domethënia e ëndrrës sime të mëparshme. Zoti im, tashmë e bëri realitet.”

Pejgamberi Jusuf për vite të tëra kishte qenë udhëheqës i drejtë në Egjipt. Ishte udhëzues dhe Pejgamber i tyre. Ai gjithmonë i thërriste për të mirën dhe për të drejtën.

Edhe Jakubi a.s., edhe Jusufi a.s. janë pejgamberët tanë. Jetën e tyre më së miri e shpjegon Kurani Kerim.

Një foshnjë në ujë; Musa a.s.


Ata që vijnë nga soji i Jakubit a.s., quhen beni - Israilë. Ata u vendosën në Egjipt pas Jusufit a.s. dhe aty, me kalimin e kohës, u shumëzuan. Mbreti i Egjiptit, Faraoni, i keqtrajtonte shumë beni-Israilët. Një natë Faraoni kishte parë një ëndërr. Magjistarët këtë ëndërr ia komentuan se do të lindte një fëmijë mashkull nga beni-Israilët dhe se ai do ta rrëzonte pushtetin e Faraonit. Me urdhrin e Faraonit, duhej të mbyteshin të gjithë fëmijët meshkuj që do të lindnin atë vit. Musai ishte fëmija

që lindi po atë vit. Nëna e Musait ishte e pikëlluar shumë dhe donte ta shpëtonte të birin. Për këtë ajo u frymëzua nga Allahu: “Ne nënën e Musait e frymëzuan: t’i japësh gji atij, e, kur të kesh frikë për të, atëherë hidhe në lumë, e mos u frikëso as mos u pikëllo, se Ne do të ta kthejmë atë dhe do ta bëjmë nga të dërguarit.”

Nëna e vet i dha gji Musait. Për herë të fundit e puthi të birin e saj të dashur dhe, duke ia lënë amanet Allahut, e vvuri në një arkë dhe e hodhi në lumin Nil. Motra e Musait ishte ende e vogël. Edhe ajo e pa Musain tek lundronte në ujë.

Lumi e barti Musain dhe e çoi para pallatit të Faraonit. Tek po shëtiste atypari, gruaja e Faraonit, Asija, e vërejtë fëmijën në arkë. Iu afrua dhe e hapi. Aty pa se ishte një fëmijë në gjumë. Menjëherë e mori në kraharor dhe nisi të përkujdesej për të. Brengosej shumë për të, sikur të ishte fëmija i saj. Pastaj, bashkë me të, shkoi te bashkëshorti i vet – Faraoni, dhe i tha që ta falte. Faraoni u pajtua me këtë dhe lejoi që Musai të jetonte në pallatin e tij. Po fëmijës i duhej nënë që t’i jepte për të thithur, por ai nuk e pranonte asnjë nënë. Motra e Musait u tha atyre se njihite një grua, e cila do t’i jepte qumësht atij, dhe në këtë mënyrë ajo e siguroi që aty të vinte nëna e vet. Kur mori vesh për këtë, nëna e Musait shkoi në pallat dhe u tha se mund t’i jepte gji fëmijës. Fëmija e pranoi këtë nënë për të thithur. Në këtë mënyrë Musai filloi të rritej në pallatin e Faraonit, bashkë me t’ëmën. Kur Musai u rrit, u largua nga pallati i Faraonit dhe shkoi në krahinë ku jetonte Shuajbi a.s., dhe aty punoi si bari për një kohë të gjatë. Njerëzit e tjerë që ishin aty, kishin pëlqyer shumë moralin dhe drejtësinë e tij. Musai aty u martua me të bijën e Shuajbit a.s.

Musai, së bashku me bashkëshorten e tij, vendosën të ktheheshin në Egjipt. Kur arritën në bjeshkën Turi – Sinaj, atij i erdhi Shpallja nga Allahu xh.sh. dhe kështu mori detyrën e



Pejgamberit a.s.. Allahu i Madhëruar kërkoi nga Musai a.s. që të shkonte tek Faraoni dhe t'i rrëfente për fenë e vërtetë. Musai a.s., së bashku me të vëllanë, Harunin a.s., shkuan tek Faraoni. Ai i tha Faraonit që të besonte Njëshmërin e Allahut xh.sh. sepse vetëm Ai është Zot, prandaj t'i bënte ibadet vetëm Atij. Nga Faraoni kërkoi gjithashtu që të mos i keqtrajtonte beni-Israilët. Mirëpo Faraoni e refuzoi këtë ftesë. Ai kërkoi nga Musai ndonjë mrekulli, me të cilën të dëshmonte pejgamberllëkun/profetësinë e tij. Musai a.s. hodhi përtokë shkopin që mbante në dorë dhe ai u shëndrrua në një gjarpër të madh. Faraoni mendoi se ajo ishte një magji dhe menjëherë i thirri magjistarët e vet dhe i urdhëroi që ta shkatërronin magjinë e Musait. Ata i provuan të gjitha mundësitë që kishin, mirëpo nuk ia dolën ta shkatërrojnë shkopin e Musait a.s.. Kur e kuptuan se ajo që kishte bërë Musai, nuk ishte magji por ishte mrekulli, magjistarët menjëherë i besuan Allahut xh.sh., po Faraoni përsëri nuk besoi. Musai a.s. e mori popullin me vete dhe vendosi të largohej së bashku me ta, nga Egjipti. Kur u informua Faraoni për këtë, përgatiti një ushtri që t'i shkatërronte, dhe iu vu pas e i zuri në bregdetin e Detit të Kuq. Musai a.s. kërkoi nga Allahu që të ndihmonte atë dhe popullin e tij. Allahu xh.sh. e urdhëroi atë që me shkopin që mbante në dorë, të godiste detin. Kur e goditi Musai a.s., deti u nda në dy pjesë. Pastaj Musai, bashkë me popullin e tij, kaluan përtej detit nëpër rrugën e hapur në det. Kur Faraoni me ushtrinë e tij deshën të kalonin në të njëjtën rrugë, deti përsëri u bashkua, kështu që Faraoni, së bashku me ushtrinë e tij, u fundosën në ujë. Në këtë mënyrë Allahu xh.sh. i mbron besimtarët nga keqbërësit.

Musai a.s. gjatë gjithë jetës së tij, kërkoi nga populli i tij që vetëm Allahun ta adhuronin dhe Atij të mos i shoqëronin askënd.

Edhe Musai a.s. është peygamber yni. Jeta e tij më së miri shpjegohet në Kurani Kerim.

Një peygamber farkëtar: Davudi a.s.

Allahu xh. sh. Davudin a.s. e zgjodhi për peygamber dhe i zbriti Zeburin. Ai ishte i njohur për zërin e tij të bukur. Për këtë shkak, në kulturën islame, atyre që e kanë zërin të bukur, u thuhet zëri yt është i bukur sikurse i Davudit a.s.. Të gjithë mahniteshin nga zëri i bukur i Davudit a.s., kur bënte dua.

Allahu xh.sh. peygamberëve që i kishte dërguar tek njerëzit, nuk u kishte dhënë vetëm njohuri fetare, veçse u kishte mësuar edhe gjëra të jetës së përditshme. Allahu xh.sh. Davudin a.s. e kishte mësuar që ta punonte hekurin. Mjeshtri i parë i hekurit ka qenë Davudi a.s.. Në këtë mënyrë, ai popullin e tij e kishte mbrojtur nga armiqtë, me parzmoret prej hekuri që kishte punuar vetë.

Edhe Davudi a.s. është peygamber yni. Jeta e tij më së miri shpjegohet në Kurani Kerim.

Pejgamberi që fliste me shpendët: Sulejmani a.s.

Allahu xh.sh., pas Davudit a.s., peygamber e dërgoi Sulejmanin a.s. Sulejmani a.s. kërkoi nga Allahu një mbretëri të madhe. Allahu xh.sh. pranoi lutjen e tij dhe atij i mësoi gjuhët e kafshëve dhe të shpendëve. Atij i dha mundësinë ta sundonte/komandonte edhe erën. Në këtë mënyrë, ai u bë mbret i madh, i cili udhëhoqi të gjitha gjallesat.

Në ushtrinë e Sulejmanit a.s. kishte edhe zogj. Një ditë, kur kishin dalë në ekspeditë, i kishte humbur një zog me emrin

Hud-Hud, dhe Sulejmani a.s., pas një kohe, me ndihmën e zogjve të tjerë, e kishte gjetur dhe e kishte pyetur për shkakun pse ishte larguar prej tyre. Hud-Hudi atij i tha se kishte zbuluar një vend që quhej Sebe, të cilin e udhëhiqte një grua me emrin Belkisa. Populli Sebe adhuronte Diellin.

Sulejmani a.s. i dërgoi letër Belkisës dhe i kishte kërkuar që ata të pranonin Njëshmërinë dhe Ekzistimin e Allahut. Atyre u bënte thirrje që të adhuronin vetëm Allahun. Belkisa e lexoi letrën, dhe pastaj i mblodhi ministrat për t'u këshilluar se ç'duhej të bënte. Ministrat i thanë se duhej të luftonin me Sulejmanin a. s., po ajo nuk donte që të luftonte, dhe si përgjigje Sulejmanit a. s. i dërgoi disa dhurata, të cilat Sulejmani a. s. nuk do t'i pranonte. Pastaj Belkisa mori rrugën vetë për ta vizituar Sulejmanin a. s., në pallatin e tij.

Para se të vinte aty Belkisa, Sulejmani a. s. ulësen e saj e solli në pallatin e vet. Kur e pa Belkisa ulësen e vet, mbeti e habitur. Përveç kësaj, atë e kishte habitur edhe Pallati që Sulejmani kishte ndërtuar mbi ujë. Belkisa e kuptoi se vetëm Allahu mund t'u dhuronte njerëzve një mundësi të tillë. Ajo e braktisi adhurimin e Diellit dhe I besoi Allahut, Krijuesit të botës.

Gjatë kohës së mbretërisë së tij, Sulejmani a. s. popullin e tij e dhe gjallesat e tjera i udhëhoqi me drejtësi.

Edhe Sulejmani a.s. është peygamber yni. Jeta e tij më së miri shpjegohet në Kuran.

Po flet një foshnjë: Ësai, i biri i Merjemes

Merjemja a.s. në vendin e saj njihej si grua me moral të mirë dhe e ndershme. Ishte nga një familje e zgjedhur në atë

vend, nga familja e Imranit. Allahu xh.sh melekun Xhebrail ia dërgoi asaj në formë të njeriut. Kur Merjemja a.s. pa burrin që nuk e njihnte, kërkoi nga ai që t'i frikësohej Allahut dhe të mos i bënte ndonjë të keqe. “Ai (Xhibrili) tha: “Unë jam vetëm i dërguar (melek) i Zotit tënd për të dhuruar ty djalë të pastër (pejgamber).” Merjemja u habit shumë dhe i tha: “Si do të kem unë djalë, kur mua nuk më është afruar njeri (nuk jam e martuar), e as nuk kam qenë e pamoralshme.” Xhebraili u përgjigj: “Ja, kështu ka thënë Zoti yt; ajo për Mua është lehtë, e për ta bërë atë (djalin e krijuar-Isain, pa baba) mrekulli për njerëzit e edhe mëshirë nga ana Jonë. Kjo është çështje e kryer!”

Ditët ditët, muajt muajt i ndoqën


Kur erdhi koha që Merjemja të lindte Isain, ajo u largua nga njerëzit dhe shkoi në një vend nën hijen e një hurme. Pas lindjes së Isait, ajo u kthye në shtëpi me fëmijën në grykë. Atë e priste një sprovë shumë e rëndë. Njerëzit, lindjen e saj pa burrë, e pritën të habitur dhe filluan ta nënçmonin atë, duke i thënë se ishte grua e pamoralshme. Ata i thanë: “Oj Merjeme, ke bërë një punë shumë të shëmtuar!” pastaj ajo u tha : “Unë nuk bëra veprë të pamoralshme. Biri im, Isai, është mrekulli nga Allahu. Nëse nuk më besoni mua, atëherë pyeteni atë.” Njerëzit e dinin se fëmija i porsalindur nuk mund të flasë. Mirëpo në atë çast ndodhi mrekulli, kur fëmija filloi të fliste: “Unë jam rob i All-llahut, mua më ka dhënë (ka caktuar të më japë) librin dhe më ka bërë pejgamber. Më ka bërë dobiprurës kudo që të jem dhe më ka porositur me namaz (falje) e zekat sa të jem gjallë!” Njerëzit u habitën nga kjo, si është e mundur të flasë një fëmijë i porsalindur. Atëherë njerëzit pushuan ta fajësonin Merjemen dhe e lanë të qetë.

Kur u rrit Isai a.s., edhe ai sikurse pejgamberët e tjerë, i thirri njerëzit që të besonin në Njëshmërinë e Allahut, të bënin vepra të mira dhe të largoheshin nga të këqijat. Ata njerëz që nuk i besuan thirrjes së shenjtë të tij, e keqtrajtuan atë dhe shokët e tij. Mirëpo Allahu xh.sh. e mbrojti atë dhe ata që i besuan atij, nga keqtrajtimet e pabesimtarëve.

Edhe Isai a.s. është pejgamberi ynë. Jetën e tij më së miri e shpjegon Kurani Kerim.

KURANI KERIM: QYTETËRIMI DHE SHPALLJA

E vërteta u qartësua me shpallje
 Me shpallje u shndrit njeriu
 Me shpallje u përgëzua
 Sepse vdekja nuk ishte fundi
 Myzhden e mori me shpallje
 Me shpallje u veçuan rrugët
 E vërteta ishte në shesh
 Imani dhe kufri dolën në shesh
 Fjalët e shenjta që zbritnin
 Për besimtarin ishin shpresë
 Për pabesimtarin ishin frikë
 Kohë-pas-kohe, periudhë-pas-periudhe
 Nga Egjipti dhe nga Roma
 Nga Kudsi, nga Meka e Medina
 Duke asgjësuar injorancën
 Ndonjëherë nga zjarri e nga pusi
 Ndonjëherë nga barku i peshkut
 Duke i shpallur namet
 Me shpallje u pastrua
 Me shpallje u përmirësua koha.



Kurani Kerim është shembull që në këtë botë u rrëfen njerëzve për bukuritë e Allahut.

Myslimani, përmes Kuranit, mund t'i vërejë bukuritë që ka krijuar Allahu.

Me Kuran mendon, me Kuran mediton, përmes Kuranit arrin të kuptojë fshehtësinë e krijimtarisë. Të gjitha librat në një aspekt, janë komentë i tij.

ISBN 975193791-4
9 789751 937919

KİTABIMI ÖĞRENİYORUM
(Arnavutça)

Eshtë dhuratë e Bashkësisë Fetare të Dijanetit
Republikës së Turqisë.